


BIBLIOTEKA

8SH-1  
V27

VARGJE  
TË  
ZGJEDHURA



891.985-1  
v 27

S

# Vargje tē zgjedhura

( BOTIM JUBILAR )

14475  
~~55059.~~

BOTIERA E SHTËPIËS  
FESTIM I 20 VJEDËV

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Botohet me rastin 25 vjetorit të themelimit të Lidhjes  
së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë.

**FSHATI ZBARDH...**

Fshati zbardh majë malit, mes pyjesh,  
Si brilant mes së gjelbrës kurorë;  
Verës ai ndrin nën dritëra yjesh,  
Dimrit ndrin nën reflekse dëbore.

Janë të reja shtëpitë, orenditë,  
Dhe ndërgjegjet, mendimet e zemrat...  
Mes së resë, kandilët, të mpitë,  
Ngjajnë si përbindsha, mes foshnjesh të ëmbla

Përmbi fshatin në mal, në çdo skutë  
Po montojnë telat tonë elektriqe,  
Dhe gjithë fshati ngjan kështu si lahutë,  
Që këndon kohën tonë heroike!

**DRINI I BARDHË PËR SHOKUN ENVER**

Me dallgë përplot n'shpërthim stuhish,  
Kur rreptë buças ndër gryka e shpella,  
Kur fryhem det, plot gjire e dredha,  
Kur trandet dheu përmes rrafshinash,  
Kur ma kush s'matet me mue n'Atdhe,  
Unë jam i vogël — i madh Ti je.

Unë jam i thellë pash e litar,  
Ku si n'pasqyrë del rrugëllimi,  
Plot male e fusha, kah m'qet shtegtimi,  
Plejni tue da për rrugë të mbarë,  
Çdo pune qoftë i jep një shtjellë,  
— N'urtësinë e kohës Ti je ma i thellë.

Unë jam dhe trim, kisha me thanë,  
Shpatën me nxjerrë, me ngajt' me kalë,  
Me da bejleg dhe gjak me falë,  
Kaçak ndër male prita me zanë,  
Me mundë baloza, me rrëxue krajli,  
— Por Ti, qe, besa, ma shkon n'trimni.

Ti besë ke rrrokë me komunizmin,  
Me krah Skënderi shekullin p'e çan,  
Nji gjurmë si t'shkambit n'ballë ia ndan,  
Tradhëtinë e mposht — revizionizmin;  
Unë, Drini, rrjedh si trim atij shpati,  
Fjalën ta ruej, Drini asht gati.

**PARA BUSTIT TË SELAM MUSAIT**

(*Baladë*)

Koha hedh pa prerë  
Përmbi festen tënde:  
Dimri — flokë bore,  
Vera — dritë hëne.

Dhe vijnë të mveshin,  
Rreth duke t'u mbledhur,  
Ndërsa ti në heshtje  
Rri në bronx i derdhur.

Eh, gjithë këtë bronx  
Gjallë ku ta gjeje,  
Vetë do ta shkrije,  
Plumba do ta bëje.

Rri... Po nuk të rrihet,  
Ndaj të vijnë mornica.  
... Vrapi yt po endet  
«Poshtë nga Babica».

... Lugjesh në ato net  
Zbrite si veri;  
Prozhektorët ndiqnin  
Sharkun tënd të zi.

Flaka nëpër duar  
Me rrëmbim të futej;  
Gjalmi mbi dyfek  
Dridhej mos këpuntej.

Plumbatë në xhepe  
(Gjetur breg pas bregu),  
Me thërrime misri  
Hynin te dyfeku;

Dhe kërcisinë egër  
Plumbat tanë të rrallë,  
Se kish shpirto misri  
Dhe desh gjak në ballë.

Malet nëpër mjergull  
Sa i zgjoi pushka,  
Kafshatën e gojës  
Varën poshtë mbi mushka.

«Bukë pér lirinë,  
Moj kasolle t'errëta;»  
Dhe u drodhën kapistrat  
Nga mushkat e serta.

«Bjeruni, o burrani!  
Hop... t'i zëmë së gjalli!»  
Dhëmbët nga urejtja  
Krisnin si stërralli.

Kështu e pësofsh  
Hasmi rrënjjëdalë:  
Kufomat përposh,  
Pëndët përmbi valë.

Deti sa të pa,  
Kur në qafë dole,  
Të thirri si nëna,  
Ti si djalë i fole;

Dhe vërviti valët,  
Sa të pa te shtegu,  
Të të mirr' te gjiri,  
Të të sill' te bregu.

Vlora krahëlidhur  
Ç'vrull të dha te gjuri;  
Malua nga ballkoni  
Të tundte flamurin.

Ndaj ti, si i dehur,  
Rrugën poshtë e more...  
Po ç'kish aq shumë tela,  
Ç'kish aq shumë llogore!

Plagë më plagë, si lule  
Ty të doli gjaku.  
Me të kuq flamuri  
T'u qëndis shajaku.

«Kështu rënçim, — fole, —  
E ç'vlen sa liria?»  
Lule, labi ynë.  
Selam Salaria!

Plumbat breshërimë  
T'u përmblodhën brenda...  
Lebrit kokë më kokë  
U mblodhën te kënga.

Si prush kënga jote  
U digjte në ballë;  
Ndërsa ti, mes këngës.  
Erdhe prapë i gjallë.

Prapë ti i pari,  
Zgjuar nga liria,  
Ti, lule stërralli,  
Selam Salaria.

Nga çdo vrimë plumbi  
Që në gjoks të shtinë,  
Tejpërtej të bukur  
Shokët panë lirinë.

Zilet e këmborët  
Heshtën përmbi pllaja.  
Lugjet prapë gjëmime  
Gatuanin ndër maja.

... Dhe sot retë nga mali,  
Që gjëmimet sjellin,  
Posi iso labe  
Vijnë e të mbështjellin.

Ti ngul sytë drejt tyre  
Si mes luftëtarësh,  
Sikur rri mendohe  
Ç'kënge do t'ja marrësh.

Buzëtë te kënga,  
Ballin te liria,  
Lule, Selam labi,  
Selam Salaria.

Çdo tufan zbërthyer  
Gjoksin ty ta gjet;  
Sharku si legjendë  
Përmbi tel të mbeti.

E të vijmë te busti,  
Si në prak të derës,  
Po ti as duhanin  
S'ke kohë të na dredhësh.

Duart i ke zënë,  
Ç'ke ashtu në duar?!  
Grykë e nxehtë e topit  
T'i ka përvëluar.

Krahët me shajak,  
Dredhur nëpër tytë,  
Hahen nëpër hekur  
Sa të shkrepin sytë.

... Ja kështu në bronx  
Ty të ka liria,  
Lule, Selam labi,  
Selam Salaria.

Përmbi festen tënde,  
Që kur ti ke rënë,  
Mali po derdh borë,  
Fusha po derdh hënë.

Dhe rri, gjoksin hapur.  
Ballë çdo furtune.  
Sharku si legjendë  
Telave të tundet.

**ASHTU MYZEQE**

(*Poemë-fragmente*)

Në majën e malit  
Barinjtë  
Kanë ndezur një flakë  
Dhe ylli i mëngjezit  
Qëndron i patundur  
Nga era,  
Që fryn me tufan.

Dhe plaku  
Dhe plaka  
Dhe foshnjat, që qajnë,  
Shikojnë me mall  
Një Ditë të Madhe,  
Që zbret nga Tomorri.

Shqiponja e lirë  
Kalon me lavdi  
Në bor' e në shi.  
Mbi male,

Mbi fusha  
E gërxhe  
Dhe nata,  
Që rri si murtajë,  
Tmerrohet.

Që larg  
Stalingradi  
Lëshon, si veriu,  
Oshëtimën e jetës pa frikë  
Dhe bota  
Dhe toka  
Përleshën me vdekjen.

Dhe ditën e parë  
U ngrit Shqipëria,  
Në fusha,  
Në male,  
Se foli Partia!  
Dhe lumi shpërthen,  
Furtuna afrohet  
Dhe zëri i shpëtimit  
Dëgjohet... dëgjohet...  
Në zemrat e tyre  
Kalon si një dallgë  
Hakmarrja  
Dhe duket liria,  
Se toka u ngrit,  
Fytyrat u ndezën  
Me driten  
Dhe beu lëkundet  
Si rrënjët e lisit

Nga vrulli tërmetit që vjen  
Dhe shëmb e rrëmbe  
Terrorin,  
Shfrytëzimin,  
Skllavërinë!

Në syrin e njerëzve  
Një rreze  
Po ndrit,  
Që ecën  
Mbi rrugën e drejtë,  
Në detin e gjërë...

Dhe, brenda një nate.  
U rritnë të gjithë.  
Sa vendi s'i nxë!

Lumenjtë  
U derdhën rrëmbyer  
Dhe valët e Vjosës  
Kënduan  
Një himn madhështor.

Kasollet u dogjën,  
Parmëndat e drunjta,  
Të lara më djers' e me lot,  
U bënë shkopinj  
Dhe gjaku,  
I mpirë nga frika,  
U bë më i kuq.

Nga zemra e dheut,  
Që u shkel  
Nga këmba e beat,  
Me rrënjet e tyre  
Po marrin  
Një këngë të re  
Dhe lëngun e jetës.

Liria  
I dehu të gjithë  
Dhe dheu  
Lëshoi një britnië,  
Lëshoi një zjarr,  
Që dogji gënjeshtren  
Në zjarrin e saj.

U ngrit Shqipëria,  
Se foli Partia!

Dhe dallga e jetës,  
U derdh nëpër fusha,  
Si dita,  
Që derdhet me vrap  
Dhe nata rrëmbe arratinë.

Fëmijët  
Me buzë të zeza  
Dhe bujku  
I rëndë si balta  
Shkëlqejnë  
Nga syri,  
Që sot ndjen gëzim!

Dhe guri i verdhë,  
Që rritej me frikë,  
Se shkonte  
Në hambarin e beat,  
U ngjit gjer në qiel,  
Se mori fuqi  
Nga zemra e dheut.

U ngrit vegjëlia,  
Me thonj' e me dhëmbë.  
Me zemrën e madhe,  
Se foli Partia!  
Dhe grushti  
Mbuloi me tmerr  
Vampirët e natës.

Në vatrat me baltë  
Jetimët po mblidhen  
Rreth zjarrit të shuar!

Sa tmerr kjo natë!

Po nata mbaroi!

Si lumi,  
Si zjarri,  
Si fjala,  
Si era,  
Si gjaku,  
Shpërtheu liria te praku.

Dhe ylli  
Dëgjonte nga lart  
Një këngë,  
Që puthte ngadalë  
Me mijëra buzë të zeza!

Dhe toka  
Vërviti me mall  
Një zë,  
Si rrufe:  
«Jeto, Myzeqe!»

14475  
~~55059.~~

SHILLOM E SHTETËS

**KUSH NDJEN MAHNITJET E AGIMIT**

Ku ndrisin yjt e kuq mbi varre,  
Na ndali hapin vendi i shenjtë...  
Dhe, në betejat çlirimtare,  
Si ranë pam' shokët e shtrenjtë.

E, në atë heshtje, veç bilbili  
Përmbi ulli ja thosh malluar  
Dhe pam' si gjethi i trëndafilit  
Dridhmonte në ashk të pakënduar

Hej, atë kangë, që në gojë  
U pati mbetur shokëve tanë,  
Tek ndizej mali si debojë  
Nga sulme të ashpra partizane.

Kushtrimi i majave i ftoi;  
Atje i panë hapësirat:  
Kur gjylja breshër shungulloi,  
U kthyen zjarr që tret zinxhirat.

Shum'herë mbeteshin barkthatë,  
Kafshonin baltën prej urisë,  
Po shkëmb i bënte dhe shtërgatë.  
U jepte gjak afshi i lirisë!

Çdo muzg, kur diellin e shikonin  
Si purpuronte kaltërsinë,  
Në kraht' e njomë përqafonin  
Të gjitha èndrrat,  
ardhmëminë.

E èmbël ishte buza e tyre,  
Siç ësht i èmbël gjiri i nënës,  
Dhe syri i dashur e plot hire,  
Si për dashnorët drita e hënës.

Në këngën vetë s'e kënduan,  
Në èndrrat vetë s'i pushtojnë,  
Për ta ne èndrrat i pushtuam,  
Për ta ne këngën po këndojmë!

Sot varret heshtin,  
                                  po në majë  
Tomori e Tatër anëmbanë,  
Fitorja hapi kraht' e saja;  
Në bebza i ndrijnë yjtë tanë.

Kush ndjen mahnitjet e agimit,  
Kush diti ç'do tē thotē brengë.  
Kush ndjen poemën e njerëzimit, --  
Ai e ndjen sot këtë kängë!

*Vlorë (Varret e Dëshmorëve)*

ORËT E VDEKURA

Sikur të ngriheshin prej varrit  
orët e vdekura gjatë orarit,  
orët e muhabetit  
në kurriz të arkës së shtetit,  
orët e munduara  
me shtiza fanellash të masakruara.  
orët e dremitjes dhe të gjumit  
të përvëlulara nga ethet e stadiumit,  
do të kishim lugetër në zyrë  
që do të na shikonin shtrembër në fytyrë  
dhe do të na thoshnin me zë të mekur:  
— Për qefin tuaj kemi vdekur!

\* \* \*

Por heshtin orët e vdekura  
pranë sobës të thekura,  
orët që prehen nën hije  
duke lexuar letra dashurije,  
orët që dëgjojnë dhe rrënkime,  
të cilat zgjaten nga e hëna gjer të shtunë:  
— Për kokën time,  
u shkriva sot në punë!

**KUR PYESJA NANËN**

Pse nuk ka tavan shtëpia jonë?  
Pyesja nanën time unë sa herë,  
Kur pikonte shiu natën vonë.  
Por çka mund të thoshte ajo e mjerë?

Dhe dallëndyshet, gjegjej, krahë kur s'kanë,  
Çerdhen s'munden edne me ndërtue.  
Kur t'më rriti ju të fortë, azganë,  
Shtëpinë tonë do nisim na me çue.

S'e kuptione ajo, se s'ish fuqia,  
Që vendoste, por padrejtësia.  
Kur të rriti, thoshte, e sigurt jam,  
Do të kemi shtëpi me tavan.

Pse nji herë në javë bajmë laknor?  
Pyesja nanën time, kur me mue  
Ajo dilte me nji trajtë në dorë  
N'ara gjeth hardhie me kërkue.

Kush ka shumë fëmijë, o bir, kështu rron.  
Se çdo gojë don bukë, çdo trup këmishë.  
Zani i saj më dukej se ankon  
Për barrën e randë — nji tufë fëmijsh.

Unë mendojsha: shtatë fëmijë? Po, shumë.  
I merrsha me radhë, bijsha n'mendime:  
Po mos t'ish ai, ajo, o unë...  
Jo, secili vend kish n'zemër time!

Nanën time e pyesja unë shpeshherë  
Për çdo gja, kur sapo hyjsha n'botë  
Për lulet që çelnin në pranverë  
Dhe për dhitë, që shkonin me kullotë.

Ajo qejfin nuk ma prishte kurrë,  
Zemra e saj për mue ishte si gurri.  
Qysh në djep m'këndonte mue përhera:  
«Ti m'u ritsh, o bir, me njiqind shqerra!»

Si shqiponja, veten rrrezikonte,  
Zogj e saj nga vdekja t'i shpëtonte.  
S'ishte ndenja e saj dhe aq e drejtë,  
Por e bardhë si bora dhe e shejtë!

Nuk u rrita unë me njiqind shqerra.  
Siç m'këndonte ajo mue përhera;  
Por u rrita n'krah me mauzerin,  
Fyt për fyt e sy për sy me Tmerrin!

\* \* \*

Po të ishte gjallë ajo kët ditë,  
Ndofta zemra prap kish me i ngri  
Nga gëzimi që shikon fëmijtë,  
Por do vdiste t'paktën n'lumtuni!

Do na mblidhte ajo posa kaçakët,  
Si dikur, të shtatë nën nji jorgan.  
Dhe megjithëse burra sot, mustakët  
S'do na i shihte. N'dhomën me tavan.

Do na rrokte si fëmij, papra  
Kaqe vjet nga malli përvëluem.  
Dhe laknorin kishte me na e nda  
Si dikur njisoj... por mue ma shumë.

Por gëzim dhe ma të madh do kish  
Kur të shihte se çati i vumë  
Gjithë atdheut, q'arna-arna ish,  
Dhe kasolleth varfanjake mbluem;

**BABALLARËT**

(*Poemë*)

1.

Në shpate ngjiti e nga shpatet zbrisni  
Të hollë si kosore e jataganë;  
Kutitë hapni e çibukët ndizni,  
E gjunjët, çlodhni,  
baballarët tanë!  
Ju shpien udhët në ara e qytete  
Dhe s'prehi kurrë  
e s'rriini kurrë,  
Po gjithnjë kërkonit nëpër jetë,  
Goditni me çekan e mbillni grurë:  
Dhe hapni libra e gazeta hapni  
Dhe ulni mbi gérma kokën;  
Mendimin e shekujve mundohi ta kapni,  
Mendimin e shekujve e mendimin e kohës.  
Dhe gérmat, të radhitura me mundim si duaj,  
Për tokën e për ju tregojnë në letër  
Shkruar nga moshatarët tuaj, e nga bijtë tuaj,  
Nga gjyshërit e stërgjyshërit e vjetër...

2.

Dhe shqetësohi shpesh për punën tonë  
Tek kuvendoni parqeve.

iëmenjve.

Të bardhat kokë tundni e mendoni:

«S'ua ha dot qeni shkopin qerratenjve!»

Mendimi juaj zgjatet edhe zgjatet

Nga kokrra e grurit

gjer te qeveria;

Kapton luginat,

fushat edhe shpatet.

Nga lëmi i fshatit

gjer te gjethësia...

Qëndroni festebardhë e mjekëroshë

Në brigjet, ku godet një lumë i lashtë.

I lashtë, valëegër e thinjoshe,

Më i lashtë

se me mijëra etër bashkë.

Dhe shihni si lag djersa jonë digën,

Dhe shihni si bie djersa nëpër valët,

Që futnin në kasolle tmerr e frikë,

Kur shfrynin si rrebesch me nëntë ballë.

Dhe thoni më me ngadalë:

«Të rinj kur qemë,

Për mjeshtra grazhdesh njiheshim nga lumi

Po bijtë tanë grazhde-diga ngrenë,

Që lumin, si në djep, ta zërë gjumi;

Nga pisha nxirrnim dritën në ato mote,

Nga uji nxjerrin dritën bijtë tanë!»

Dhe rrini bregut veshur me qillota,

Të hollë si kosore e jataganë.

Në qiel ngrini sytë tuaj të mplakur  
Dhe shihni  
vija-brazda reaktivësh,  
Që dridhen në agimin e përflakur  
Dhe ju kujtojnë gërmat arabishte...  
E thoni me ngadalë:

«Të rinj kur qemë,  
Në arabara hipnim, e në qerre,  
Po bijtë tanë poshtë e lënë dhenë  
Dhe ngrihen sipër reve!  
Ahore krahë kishim ne të zinjtë,  
Po koha krahët na i kish prerë!»  
Çibukët i përpinqni në shkëmbinjtë,  
Duhan i fortë gurëve bie erë...»

### 3.

Ju,

baballarët,  
mendime tirni, tirni.

Ju,

baballarët,  
natën s'keni gjumë,

Mejtoni si, ne vendin nikoqirim  
E thoni:

«Bijtë kanë andralla shumë!»  
Dhe vjen tek ju me vrap zhurmë e turbinave,  
Vjen kollë e buldozerëve të hekurt,  
Vjen gulç i mbytur i maqinave,  
Vjen erë, e kallëzve të pjekur...»

4.

Kjo zhurmë e erë pa gjumë ju lë, natën,  
Se hapin tonë ndiqni,

rrini pranë;

Të bardhat kokë tundni buzë vatrës:

«Të fortë dolën bijtë tanë!»

Eh,

baballarë,

kjo vatër ne na polli,

Këta thëngjij të kuq na mbajtën nxehthë,

Ky lesh velenxash trupin na mbështolli.

Ky prak na nisi udhëve në jetë...

Në dejtë tanë gjaku juaj ecën

I nxehthë,

si në motet tuaja rinore,

Kur vriteshit me plumb për të vërtetën

Në brazda e në male me dëborë.

A s'ishit ju ata që me Selamnë

U derdhët, kur rënkonte Vlora jonë,

Nga grykat zutë topat italianë,

Rrëzuat me tre plumbë një ballonë?

A s'ishit ju ata që me Bajramnë

E ndërruat në legjendë Dragobinë?

Me gjoks i pritët plumbat dhe murlanë,

Me plagë e mbartët udhëve urinë? . .

5.

Ne shpesh

në faqe malesh,

nëpër gurë,

Zbulojmë ndonjë top të heshtur  
Me rrota të copëtuara,

të murme,

Diku hendekut hedhur...

Dhe themi të mejtuar:

«Baballarët

I bënë të pushojnë këta topa,  
Gatuar me çelik nga ustallarët,  
Mësuar e stërvitur nga Evropa...»

Ne shpesh

mejtohemi

nëpër muzera,

Tek shohim varur stendave të ndritshme  
Nagantë,

jataganë

e malipherë,

Të vjetër e me marka të çuditshme

Dhe themi:

«Baballarët tanë i mbajtën,

Nga brezi nuk i hoqën kurrë

Dhe në llogore hasmëve u vajtën,

Kur s'patën plumba,

shtinë dhe me gurë!»

## 6.

Ne shpesh

mejtojmë

e hidhemi në vite,

Kur ju mbi hasra edhe dru prej pishe

Ushtarët e revolucionit rritët

Me thërrime buke e thërrime gjize.

Dhe ishim ne ata ushtarë — èndrra,  
Që hapnim sytë në odat murenxira,  
Që binin erë qepë e erë mëndra,  
Që binin erë hudhër e kumpira...  
Që hapnim sytë nën kabatë e lashta  
Përcjellë nëpër fyell e gërnetë  
Nën trarë e çati me rrashta,  
Që ngritën me mundime pleqtë.  
Nuk fjetëm në krevatë e në susta,  
Siç flinîn moshatarët tanë në botë,  
Dhe nënënat mbi djepet e ngushta  
S'na varën kuklla,

po gjerdhanë me lot.

Me drutë e pyllit bëtë djepet tonë  
Dhe plumba nëpër drutë e pyllit gjetët  
Mbi plumba,

futur në pelena.

qamë,

Mbi plumba

ne,

fëmijët tuaj,

fjetëm! . .

7.

Kështu na bëtë burra,  
baballarë!  
Ne qemë ushtarët e revolucionit,  
Që me durim të fortë prej kopshtari,  
Guximin çast më çast ju na mëkonit.  
E thoshit:

«Shtigje të mëdha do çajnë,

Të tjera nga të baballarëve!»  
Dhe ikëm nga shtëpitë partizanë,  
Dhe ikëm larg pas komisarëve.

8.

Dhe morëm pasëndrrat tuaja të mira,  
Më të bukuratëndrra shekullore  
Për lirinë e përtokat e lira,  
Për njerinë e përvatrat paqëtore;  
Dhe i bashkuam meëndrrën tonë të madhe,  
Meëndrrën që quhej komunizëm.  
Ju kuvendonit në arë e livadhe  
Dhe ju dukej kjo fjalë më e rëndë se qilizmë.  
Po kur armiqtë merrnin nëpërgojë  
Dhe fyjenëëndrrën tonë të shtrenjtë.  
Para saj ju vinit gjokset si dëbojë,  
Si para altarit të shenjtë.

9.

Në shpate ngjiti e nga shpatet zbrisni,  
Të hollë si kosore e jataganë,  
Kutitë nxirrni e çibukët ndizni,  
Për bijtë mendjen vrisni,  
etrit tanë! . .

Po ndodh që herë-herë ju prishet gjaku.  
Kur ne ndonjë zakon të vjetër shkulim;  
Ju heshtni me çibukë te oxhaku  
E kokët nëpërtym duhani ulni:  
Mëri u mbani mbesave të bukura,  
Gishterinjtë e thatë tundni rrëptë,

Kur kthehen natën vonë faqeskuqura.

«Na bëkan dashuri me djemtë!»

Por kur ju del inati, lini mashat

Dhe mblidhi një nga një nëpër sofate.

Mendimet zgjatni larg

si brazdat,

Si shtigjet nëpër mal e monopate:

«Eh,

ka lezet zakoni,

mor të urtë,

Na ndoqi pas zakoni nëpër mote,

Si kjo kuti me pak duhan të butë,

Si ky çibuk me pak duhan të fortë.

Kjo guna jonë ç'llohë e ç'shira hoqi!

Të ndahesh nga zakoni

s'qenka lehtë,

Ky djall çerep

të tillë brumë poqi

Nën këtë saç

të rëndë

e të nxehjtë! . . .

Po,

baballarë,

e keni të vështirë

T'ua veshni brucin ligjeve të reja!

Po me zakonin s'ikte blozë e nxirë

Dhe s'ngrihej Azotiku

e Va-Deja!

Po me zakonin èndrra jonë e bukur,

Që ju e mbrojtët para bajonetës,

Nuk kthehej në turbinë e në bukë,

Nuk bëhej jetë. . .

Ju vetë ligjin e përgjakur prishtë,  
Që kur ne dolëm malit partizanë;  
Ju vetë ligjin e hakmarrjes gristë,  
Kur bashkë ndiqnim laron dhe dushmanë . . .  
Ashtu si heshti krisma e hakmarrjes,  
Po heshtin pashkë e ramazanë,  
Se rrugën tonë drita e ka larë,  
Se baballarë e bij një zemër kanë . . .

10.

Mendimi juaj zgjatet  
                                edhe zgjatet  
Nga kokrra e grurit  
                                gjer te qeveria,  
Kapton luginat,  
                                fushat edhe shpatet  
Nga lëmi i fshatit  
                                gjer te gjithësia . . .  
Dhe pranë radios mendjen rrini vrisni:  
«Si shkojnë baballarë e bij në botë?»  
Në caqet,  
                                ku i errët është agimi,  
I ndan një akullnajë e ftohtë!  
Bërtasin narkomanët:  
                                «Etërit janë mykur,  
Me ta në paqe ne,  
                                modernët,  
                                s'rrojmë,  
Në pleqërinë e tyre janë zhytur  
Dhe mes anakronizmave notojnë!»  
Dhe poetucët vargje stisin,  
                                vargje thurën

Dhe lëngje vargjesh derdhin mbi «të vjetrit»  
Ndër kabaretë modë e «izma» mburrin,  
Si setra demodé i flakin etërit!  
E dini

cilët janë,  
baballarët?

Ata sot hedhin tuist fytyrëflakë  
E nesër vrasin vietnamezë në arë,  
E nesër ngasin tanket nëpër Pragë!

11.

Ju,

baballarë,

keni djem të mirë,  
Se ëndrrat i bashkuam në një ëndërr,  
Se grurin tok e kemi shirë,  
Ndaj njëri-tjetrin nuk e shohim vëngë<sup>er</sup>  
Dhe kur dikush,

këlysh mikroborgjezi,  
Me petkun progresiv na vjen vërdallë  
Dhe sherrin etér-bij kërkon të ndezë,  
Ja shkulim dhëmbë

e dhëmballë...  
Dhe kur dikush

me pantallonat-tuba  
Mundohet të ngërdheshet para jush  
Në trotuar,

sikur të lozë rumba,  
Ne nxehemi e bëhem si prush!  
Dhe kur dikush

ka turp me ju të rrëjë  
Në restorant e kafené a klub,

Ne me përbuzje sytë i vetëtijmë  
Dhe ndofta mund të rrihem me grusht;  
Kërkënd s'lejojmë ne me ju të tallet,  
O baballarët tanë,  
Se ju mbi shpina mbajtët tërë hallet  
Dhe Shqipërisë i dolët zot  
  me jataganë!

Dhe gjithshka e bukur e bujare  
U ngrit mbi supet tuaj hekur,  
Nga peshë e kohës kërrusur edhe vrarë.  
Nën saç të kohës thekur...

12.

U mplakët,  
baballarët tanë,  
  u mplakët!  
Ndonjë prej jush mbyll sytë ndaj të gdhirë  
Dhe pranë vatrës prushin lë dhe flakën.  
Çibukun dhe duhanin e papirë...  
Dhe ne lexojmë, ndër nekrologjité,  
Rrethuar me korniza, emrat tuaj  
Dhe heshtim për një çast të trishtë  
Mbi torno,  
  diga,  
  libra,  
  duaj...  
I njobhim mirë ata dy sy të urtë,  
Mes katër vijave të zeza vënë,  
Në një nekrologji të shkurtër,  
Që këndin e gazetave ka zënë...  
I njobhim mirë!  
  Ashtu ju kemi parë

Në vatrat e shtëpive partizane,  
Kur bukën dyzet copë e kemi ndarë,  
Kur njëzet veta hidhnikim tre jorganë,  
Kur vajin e fëmijëve të mitur  
E digjnit në kutinë e vjetër,  
Që oda të ish e pastër dhe e ndritur,  
Që ne të shihnim sytë e njëri-tjetrit.  
A s'ishit ju

që në nëndor shtëpinë  
E hapët edhe çelësat na dhatë,  
Dhe lindëm ne te vatra juaj Partinë  
Mbi një rrugoz e një minder të varfër?  
A s'ishit ju që mbajtët Enver Hoxhën  
Dhe rrobat bërë qull në mal ja thatë,  
Opingat partizane, grisur shqotës.  
Ja qepët, kur rëndonte nata e gjatë,  
Kur malet në stuhi e zulm gjëmonin  
Marshimeve të dimrave mes borës;  
Kur nën helmeta të egra e përgjonin  
Banditet e Berllinit e të Romës?  
A s'ishit ju që shtigjeve brigadat  
I nxorët, nëpër breshër e furtunë  
Në grykat e përrrenjeve e në shpatet.  
Kur shkrepat nëpër plumbë bën zhurmë?  
A s'ishit ju, që vinit nëpër burgje  
Dhe zemër neve,

bijve tuaj,

na jepnit

Dhe iknit shpirtcopëtar, nëpër muzgje  
Dhe tundnit kokët:

«Djema,

mos u epni!»?

A s'ishit ju që bijtë, kur iu vranë,  
Dyfeqet stërgjyshore hodhët krahut.  
Në festë vutë yjet partizanë,  
Përgjysmë latë brazdën edhe vrahun?..  
Ju njohim mirë:

Ashtu ju kemi parë,  
Të dashur,  
                                  kur ne zbrisnim në lugina,  
Dhe ju na përqafonit,  
                                  baballarë,  
Dhe xhepet na i mbushnit me mollçina... .

### 13.

Dhe ne u bëmë baballarë,  
                                  baballarë!

Dhe gjaku, i përcjellë nga epoka  
Te bijtë, le të rrjedhë në damarë,  
Që pulsin si çekan ta ndjejë toka!  
E tillë qenka jeta:

valë-valë

Në dhenë e lashtë baballarët vijnë  
Me një mendim të brezave  
                                  në ballë,

Si lapidar i bardhë në kodrinë.  
Dhe ne na shqetësojnë bijtë tanë  
Dhe shpesh për ta mendimet na trazojnë.  
Se shekulli ka diell 'e tramundanë  
Dhe s'është karamele koha jonë.  
Në veshët tanë plumbat vërshëllejnjë  
Ndaj erën e barutit,  
                                  përmes shkrepave,

Ne dimë ta nuhatim e ta ndjejmë  
Në largësinë e treqind kilometrave:  
Nga lartësi e majave alpine,  
Ku bora s'e zhvesh gunën kurrë,  
Gjer poshtë Konispolit në lugine,  
Ku krahët portokalli tund mbi grurë...  
Dhe bijve tanë u themi ashpër:  
«Kërkoni,

bij,  
e ndeshuni në jetë  
Dhe çani rrugë të mëdha  
shpirtpastër,  
Siç çanë baballarët tuaj të rreptë,  
Dhe mos harroni kurrë baballarët,  
Që maleve të ritë e tyre lanë,  
Që qenë në revolucion ushtarë  
Dhe erdhën me fitore në Tiranë...»  
Pa çka se ndonjëherë shajmë rëndë  
Dikë nga bijtë tanë çamarokë.  
Ata me muskuj dhe me mendje  
Më lart se etërit do ta ngrenë këtë tokë,  
Se dheu i saj dhe uji i saj i kaltër,  
Nën qiejt, që gjëmojnë e ndritin,  
Nga vatra gjer në vatër  
Vec breza burrërorë  
rritin...

14.

U mplakët,  
baballarët tanë,  
u mplakët,

I mbushët xhepe e torba plot me vite;  
I përcëlluat gunat nëpër flakët,  
I gristë tallaganet në syngjité  
Dhe mbetët gjithnjë të hijshëm,  
Bujarë e të çiltër si furtuna,  
Me ballë të brazduar nga mendimet,  
Me duar të lëruara nga puna.  
Dhe shkojnë motet,

bën të sajën koha,  
Ju mplaki edhe kërrusi si kosorë,  
Po para nesh ju ngrihi si epoka,  
Fisnikë,

madhështorë! ..

Prill, 1969

**MËNGJEZ VOTIMESH**

Mëngjez, diell.

Për drejtësinë, e dashur, votuam, 20

Për atë drejtësi

Që ëndërruam

Dhe unë e ti.

Lemë të pi

Gazin që ndrit në sytë e tu,

Gazin që po 'të çel në buzë,

Gazin që m'ep me dorën kupë.

Mëngjez, diell.

Ruga në shend shëndrit.

Një palë venë,

Një palë vijnë

Shtegtim për drejtësinë —

Ky shtegtim në kaqë dritë.

Një vogëlush mëson të rendë

Mbi xhade.

Gjyshi mezi e ndjek  
Edhe bërtet:  
— Ilir!  
Pastaj të lirë e lë  
Të rendë.

Bulevardi rrëshqet  
Midis dy gjerdhesh të praruara.  
Nëndor, pothuaj kanë lulëzuar  
Mimoza latjmëtare të pranverës.  
Të voglin e ndjell  
Gjith' rrezatimi, që feston.  
Gjyshin e dehu vlaga e vjeshtës  
dhe zemra e tij përgjon  
Zërin që buçet  
Në radio për rininë.

Mbi piedestal, Naimin  
Përjetësish e frymëzon  
E flakta dashuri për njerinë,  
Vëllazërimi botëror.  
Dhe nga një prak graniti  
Buçet thirrje e Leninit mbi Tiranë,  
Si botës anembanë,  
Për drejtësinë,  
Për çlirimbotëror.

Pate menduar ndonjëherë, o gjysht.  
Që të votosh për drejtësinë?

Çdo zhubr' i fsheh tek ti  
Njëj plage historinë.  
Ke njohur dëshpërimin,  
Njeh shpëtimin  
që kush e di sa pate ëndërruar.

Drejtësia qe ëndërr fshikulluar  
Nga kërbaç i kromosur  
I xhandarit;  
Endërr përqeshur  
Nga turiri i gjakosur  
I mbretit;  
Ëndërr therur  
Nga shishi i sterosur  
I fashistit.

Gjyshi i qesh mëngjezit  
Tamam si drejtësë.  
Më nuk e tremb  
Vrapi i guximshëm i fëmisë:  
Të rendë,  
Le të rendë,  
Të gjejë fluturën krahëshkruar nëpër fletë.

Mëngjez, diell.  
Mbi bulevardin «Shqipëria e re»  
Si lumë qenke bërë sot, hare.  
Midis dy gjerdhesh prarimi.  
Është burimi

I vet' drejtësisë,  
I Partisë,  
Që gurgullon nën diell.

Për drejtësi kemi votuar,  
Ashtu si patëmëndërruar.  
Gazi gufon.  
Ne kupën plot ta pimë nga kjo verë.  
E dashur, është verë e jetës sonë.

16 nëndor 1958.

**DE RADA**

Tej detit, larg, i zymtë mbet De Rada,  
Bastuni i tij, që brodhi horë më horë;  
Nën tinguj fjetën të tijat flokë të bardha  
Dhe mjekra e tij e bardhë si dëborë

Lëkur' e rreshkur i ra mbi kraharorë.  
Iu mbyllën sytë e buhavitur.  
Për ku po nisej gjaku arbëror.  
Për ku i djegur, i zhuritur?

Që bushtra erë të mbërrinte gjer te shtrati?  
Ja, Milosaua mbet te lum' i Vodhit,  
Po gjaku i tij në këngë e rreshta  
Një shekull krejt kulloj e rrođhi.

U ftoh në vatér heshtur hiri i fundit,  
Palltua e rëndë rri varur në peronë,  
Buçet e rreh stuhia rreth katundit,  
Maki po hesht e San Demetër Koronë.

Në xhep e mykur një copë buk' e thatë,  
E zhveshur krejt e ftohta dysheme  
Dhe miu breu ndofta atë natë  
Një copë nga «Pa fanmi Skanderbe».

Ai thërret, atdheu i përgjigjet  
Me bubullimë valësh përmbi shur;  
Ai thërret, në flakë lindja digjet,  
Në brigjet tona hapet si flamur.

Dhe niset mes dallgëve të vijë  
Dhe zgjat gishtrinjtë, tutje erën prek,  
Se tokë e huaj shtrat nuk mund t'i rrijë,  
Se tokë e huaj eshtërat i djeg.

**JU FLET TIRANA**

Ekte mësuesi shtigjeve të malësisë,  
I rrihte trupin breshni e tramundana,  
Pranë i buçiste zani i partisë:

«Ju flet Tirana...»

Mbante në gjoks biletën e ushtrisë.  
Buçiste lumi i Kirit me rropama,  
Naltohej përmbi zhurmën e stuhisë:

«Ju flet Tirana...»

Ndalu, i thoshte breshni me zemërim,  
Pse nuk qëndrove, n'shipi e smurë asht nana,  
Nga radioja buçiste si kushtrim:

«Ju flet Tirana...»

Qyteti asht në festë, ti lejë ke,  
Ty të pëlqejnë teatri, filmi, mbramjet...  
Po radioja vazhdonte me hare:

«Po japid lajmet...»

Kush vlen ma shumë, detyra apo jeta,  
Na paske marrë dhe radion e shtëpisë?  
Përgjigjej çiftelia dhe gërneta:

«I këndojmë partisë. . .»

Ti nesër paske mësim, eh, pun e madhe!  
Rrogën e more, gjëzo lejën tandem,  
Radio Tirana jepte kësaj radhe

«Kangë partizane. . .»

«Flokëqethun ti nuk matesh dót me mua.  
I foli e tërbueme tramundana.

Mësusि buzëqeshte, tue ndëgjue:

«Fliste Tirana

E prisin malësorët me festue  
T'kuqin nandor, së bashku ndër këto ana,  
Me u mbledhë aty të shkolla e me ndëgjue  
Kur flet Tirana

Me këtë andërr u gremis në humnerë.  
Mali gjëmoi dhe qeshi trámundana.  
Po spikeri buçiti si pérherë:

«Ju flet Tirana. . .»

Ai prap udhëton ndër shtigje të malësisë.  
E shohin, e dëgjojnë si katër ana,  
u flet për të gjithë zemrave t'Shqipnisë:

Radio Tirana. . .

**PAS MBLEDHJES**

Ty të kritikuan  
Dhe veten kritikove,  
Dhe dole nga mbledhja...  
Dole kokulur, i skuqur, sigurisht,  
Ashtu si sëpata që del nga kovaçi,  
Pakës e skuqur, e nxehur,  
Por e kalitur, e mprehur, dyfish,  
Dhe bie  
      mbi trungjet  
          e vjetër  
            pastaj,  
Dhe trungjet e vjetër i ndan më dysh.

**ATO MAJA RRIPA-RRIPA...**

Ato maja rripa-rripa seç gjëmojnë,  
Ndizet lufta për liri e derdhet gjak.  
Janë trimat partizanë që luftojnë.  
Janë bijtë e Shqipëris' që marrin hak.

Sot po dridhet tirania anembanë,  
Sot po digjet e po bëhet shkrumb e hi,  
Se u mbushën malet plot me partizanë,  
Se u ngrit sot gjith' rinia për liri.

Më përpara një flamur të kuq në duar  
Dhe një torbë me fyshekë e një dyfek,  
Të cfilitur prej fashizmit, të copëtuar,  
Turren trimat e luftojnë shtek më shtek.

Sot po dridhet tirania anembanë,  
Sot po digjet e po bëhet shkrumb e hi  
Se u mbushën malet plot me partizanë,  
Se u ngrit sot gjith' rinia për liri.

*Viti 1943*

**ISHA KAQ I VOGËL...**

(*Poemë*)

U dola përpara agimeve të mëdha,  
Kur bota përtypë  
Hekur... hekur... hekur...

Në kurrizin e globit  
Marshonin ushtri të çuditshme:  
Ushtri njerzish, gavetash,  
Ligjesh, galetash,  
Ushtri bataniesh  
E flamujsh.

Inkuizitorët modernë të lirive të reja  
Marshonin — hordhi, nën helmeta.

Nën helmeta — qelbje mejtimesh.  
Nën helmeta qelbje prej krimesh.

U dola pérpara' agimeve tē mëdha,  
Kur bota, me nofulla tē veta,  
Pértypte tragjeditē e saja.

Dhe bënte ftohtë. Ftohtë. Ftohtë.  
Unë ecja me këmbë tē zbathura,  
Mbi mendime tē ngrira prej frikës.  
Putrat më çaheshin, nëpër ngrica ndjenjash  
Të thyera, si copëra qelqesh.

Dhe bënte ftohtë. Ftohtë. Ftohtë.  
Dhe vetëm' marrëzia e botës digjesh.  
Njerëzit në marrëzinë e tyre ngrohnin duart.  
Rruzulli shëmbellente me një buall  
Me lëkurë tē pérzhitur,  
Që përtypte vetëm hekur... hekur... hekur...

Isha kaq i vogël  
Para çmendurisë së mëdhe tē kohës;  
Isha kaq i paditur  
Para tradhëtisë së mençme tē botës.

Unë isha i vogël, kërthi  
Para krimeve tē thinjura.

Dhe me sy tē pafajshëm fëminorë  
Shikoja në ato ditë luftrash i tmerruar,  
Si në retinën e syve tē shqyer  
Të shekujve.

Dhe me turmat, që vërshonin si lumi,  
Rreth prushit të marrëzisë njerëzore,  
Vajta dhe unë të ngrohja duart.

Dhe më mori gjumi . . .  
Dhe më zuri gjumi . . .

## II

Dikush, me dorën e tij të ashpër,  
Më shpupuriti flokët  
E më ngriti peshë në ajër.  
U zgjova me llahtar,  
Kur ai më tha: «Mos u frikëso . . . mos u trishto . . .  
S'ke ardhur në jetë  
As vonë e as tepër shpejt,  
Ke ardhur në kohë.»  
Dhe me gishtin e tij të madh  
Më shtypi majën e hundës përpjetë  
E qeshi.

Ngà e qeshura e tij horizontet gjëmonin —  
Ishte revolucioni . . .

Më shkoi dorën e ashpër  
Nëpër flokët e shpupurit  
Dhe përnjëherësh nën kafkë  
U përflekën mendime të ndritura

Dhe pashë  
Nëpër gërmadha, mes atij të ftohti,  
Të shpërthenin prapë mendime të bukura.  
Me kapotat e leshta mbështilleshin liritë.  
Nga rrudhat e ballit të botës,  
Rinia e jetës 'lindte  
Si mes valëve të detit një Afërditë.

Unë ecja zbathur mes atij të ftohti  
Dhe 'ndjeja: kurrizin e globit  
E përshkonin mornica gjëzimi,  
Uturimat e revolucionit.

Nga e qeshura e tij, si e qeshura e një demoni,  
Kohërat gjëmonin...  
Rruzulli përtyppte hekur... hekur... hekur...  
Nën çizmet me gozhda të SS-it  
Ëndrrat e njerëzve  
Si copëra kallkani thyheshin.  
Po njerëzit filluan të pyesin:  
«Pse kështu?»  
Njerëzit thoshnin: «Mjaft më kështu!»

Dhe bisedonin  
Me revolucionin.  
Dhe unë me lehtësinë  
Që zgjidh një gllomçkë të shamisë,  
Zgjidha ashtu  
Kuptimin e madh të historisë.  
Unë e kuptova: njerëzit bëjnë historinë,  
Kur pyesin: «Pse kështu?»  
Kur thonë: «Mjaft më kështu!»

### III

Unë i përkas revolucionit,  
Asnjë medalion,  
Asnjë distinktiv nuk mbaj në krahëror,  
Veç si medalje të thjeshtë kujtimi  
Plagën e shokëve të rënë.

Rreth qafës  
Nuk vara kurre  
As Jesu Krisht e as Gjysmëhënë.  
Mbaj hajmali një copë të flakës  
Së revolucionit.  
Unë jam i turbullt, si dallgët  
E turbullta të revolucionit.

Që kur e kuptova se gjithë bajonetat,  
Gjithë piramidat,  
Gjithë ligjet gjakatare.  
S'vlejnë as sa karficat, me të cilat kopsitim  
Floket e vajzave — i përkas komunizmit.

Eci nëpër botë e shtrydh e rrufis,  
Si limon të verdhë, dashuritë,  
Mendimet, dëshirat. I shtrydh, i rrufis.  
Dhe pastaj,  
Si limonin e verdhë — i hedh tej.  
Vetëm njërit i qëndroj besnik  
Përgjithnjë e gjer në vdekje — komunizmit!

Unë jam i turbullt.  
Dhe botën mund ta shoh të kthjellë  
Vetëm mes dallgëve të turbullta të revolucioneve.

Eci në jetë,  
Jo si provincial i gjorë, që sytë i shqyen  
Nga dritat e reklameve të neoneve.

Të gjitha dritat e horizonteve,  
Të gjitha dritat e mendimeve të revolucioneve  
I futa  
Dhe ndjej vibrationet e gëzuara të tyre  
Nën këtë këmishë të pastër me lulka.  
Dhe nuk i lyp kurrkujt as urrejtjen e as  
dashurinë,

As mbrojtje e as ndihmë.  
Më mjafton që me dorën e tij të ashpër,  
Flokët m'i shpupuriti revolucioni im.

Unë  
U dola përpara agimeve të mëdha.  
Nëpër muzgjet e tyre eci  
Mbi eshtra e skelete shekujsh.  
Dhe kur llodhem — për t'u çlodhur —  
(Më dëgjoni?),  
Për t'u çlodhur kryet e turbullt pështes  
Mbi supe të revolucionit.

**BALLADË E DJALIT**

Tridhjet' këmbësorë, një daulle-bum,  
Me vdekjen ngarkuar ecin kuturum.

Një djalosh gjermanët para e kan' marrë.  
Vetëm sepse tha: «vdes si shqipëtar».

Ndizet flak' baroti, 'tridhjet' bëtare,  
Si një lis vigan djali ra përdhe.

Po atje, pa pritur, mbinte lart krenare  
Zëmra e djaloshit përmbi lapidare.

ULLINJTE

(*Shënimë nga një aksion*)

Ullinjtë flinin.

Ma tutje flinte deti.

Degët e mundueme dhe të përdredhuna nga dhimbja  
e kohnave

Lëkundeshin nën qiellin e blertë të gjetheve.

Që herët

Në breg lozni fëmijët e peshkatarëve,

Peshkatarët flinin akoma pas natës së ujnave.

Fëmijët lozni përballë ujnave dhe ditëve të panjo-  
huna e të gëzueme.

Befas ra daullja.

Zhurmat iknin mbi rivierë.

Fshatrat e varuna mbi mjergulla u zgjuen.

Zhurmat iknin, iknin

Mbi dritat, që u ndezën si galaktika ndanë detit,

Mbi minutat e fundit të natës.

Mbi luginat,

Mbi shkambinjtë.  
Daullja, që ra që me natë,  
I zgjoi edhe ullinjtë.

\* \* \*

Nga sfondi shkëputen udhët, oxhaqet, betonarmetë  
e para,  
Qytet i dashtun, gjysmëvizatue nga dielli që po lind!  
Maqinat ulërijnë në mal, si delet,  
Po vijnë kolonat me pyjet e fidanave ndër duer.  
O, këto s'janë fidane,  
Po kodra me ullinjtë!

\* \* \*

Bie daullja.  
Pyjet e pafund të ullinjve zhurmojnë ndër duert e  
njerëzve.  
Mbi degët e tyne të njoma zhurmon era pa da.  
Unë renda në këtë peisazh të gëzuem që e mbanin  
njerëzit ndër duer

Dhe pashë shamitë e bardha dhe të bukura  
Të mbledhëseve të ullinjve.  
Që mblidhnin me kangën e tyne  
Kokrrat nëpër bar...

Qeshnin shamibardhat dhe vraponin  
Nga ullishtet që mbollën ilirët me patërshana mbi  
bregdet.

Vajza! Këta ullinj nuk i mbollën arbërit harkëtarë,  
Po aksionistët e vtitit 70.

\* \* \*

Ecin njerëzit me ullinjtë mbi rivierë,  
Deti fle ende.  
Asht akoma natë.  
Pyjet me ullinjtë lëvizin mes kodrave,  
Para erës që i ndjek:  
Ku e shpien këtë peisazh?

\* \* \*

Riviera dhe njerëzit...  
Vërtet, ku e shpien këtë peisazh të gjanë?  
Do ta varin mbi kodrat e kaltra, ndanë detit,  
Siç varim ndanë dritares një kuadër.  
Daullja, që ra që me natë,  
I zgjoi dhe ullinjtë pleq,  
Ullinjtë madhështorë, si mbretnit ilirë  
Dhe në kujtesën e tyne të gjelbër u zgjuen  
Arbërit shigjetarë  
Me patershana dhe ullinjtë ndër duer...

Ullinjtë mbajnë mend gjakun dhe luftën,  
Etnit, që kaluen nën ta dhe na i vranë:  
Ata ngritën kokët nën format mitologjike të reve,  
Panë qiellin e gjelbër të gjethive,  
Degët e ullinjeve,  
Që u përdrodhën nga dhimbja për ta.

\* \* \*

Dikush e këndoi kangën e ullinjve;  
Rrihte dheun përreth drunjve, që lëkundeshin  
Si në një valle popullore,  
Gemat e blertë ranë, si flokë mbi të dhe qeshi  
Ai që këndoi kangën e ullinjve.

\* \* \*

Ndodhi kështu:  
Në një ditë lindën gjithë këto pyje.  
Në fund u ulën aksionistët mbi bregdet dhe menduen:  
Ç' emën t'u vemë ullinjve?

Pastaj zbritën me kangë nga kodrat.  
Zani i gajdeve nga ullinjtë varej:  
Lanë pyjet me ullinj mbi detin e kaltër.  
Sikur lanë një lule mbi dritare.

**KUR ZGJOHEN BJESHKËT**

Kur zgjohen bjeshkët, hedhin sytë nga fushat,  
Aîsh i mëngjezit ndez dëshirën pâr punë;  
Shamitë e aksionit zbukurojnë gushat  
Siç zbukuron kodrat, pranverës një lumë.

Shamitë e aksionit dhe pantallonat gri  
Mbetën në trupin e cucave malësore  
Një kujtim i bukur — peisazh i ri  
Mbi shkrepat dhe shamitë e zeza shekulliore.

Me flokë të lirë shpupurisur në fllad  
Të parat rendin këto cuca përsëri  
Aty ku hapet rrugë e re në fshat,  
Duke thyer shkëmbenj dhe koncepte me qysqi.

**PRANË ULLINJVE**

Po të pres, e dashur, te ky trung i lashtë.

Mbrëmja, ja, u ul  
Mbi kurriz të ullinjvet.  
Drurët nëpër gishta  
Yjet numërojnë,  
Porsi pleqtë e moçëm netve tespihet.

Te ky trung i lashtë unë rri e pres.

Ky ulli i moçëm me degët e tij  
Mbulon heshtjen time,  
Ky ulli i moçëm,  
Që rrënjjët ka shtrirë thellë lashtësisë.  
Kushedi se ç'dorë e mbolli këtu:  
Ndoshta dy të rinj  
Si unë e ti,  
Dy stërgjyshër tanë  
Që as varr, as emër përmby tokë s'kanë.

Kushedi sa herë u ndërruan shekujt  
Dhe të kërrusur shkuan  
Nën degët e tij,  
Kushedi sa herë e shkundën me shufër,  
U përkulën shekujt  
Duke mbledhur kokrrat  
Nën këtë ulli!

Hej ulliri i moçëm,  
Që me këto degë mbulon ankthin tim!  
Këtu ku rri unë,  
Sa pushkë ja morën këngës për liri?  
Dhe pastaj aty,  
Ku qëlloi pushka.  
Flokë dashurie,  
Puthje dashurie erdhën dhe u derdhën.  
Apo, jo, ulli?  
... Dhe shikoje ti në ditët me mjegull.  
Qysh, pas çdo beteje,  
Vlora zgjaste dorën të prekte Sazanin.  
Porsi nëna natën, që zgjohet shpeshherë  
Të shikojë djalin...

Ti, e dashur, s'erdhe  
Që të ndjenim bashkë  
Parfumin e verdhë,  
Që hëna ullinjve mbrëmjeve u derdh.

Ti duhej të vije,  
Që ulliri i moçëm të mos e mbulonte  
Vetëm heshtjen time

Dhe brengat e tij,  
Porse puthjet tona sonte të mbulonte.

Por nuk do trishtohem,  
S'do ta mbaj vetëminë mbi lotët e mi.  
Unë fare mirë  
Mund të rri i heshtur  
Nën këta ullinj,  
T'i ndjej frymën tokës, tokës aq të shtrenjtë,  
Të gjurmoj ku jeta  
U përlesh me vdekjen,  
Të gjurmoj ku rrënjet i ka shtrirë jeta.

Dhe kështu i vetëm  
S'do bie në mendime  
Pse s'u duke ti,  
Por nën cip' të mbrëmjes dhe nën hijen time  
Do kërkoj, e dashur,  
Tjetër dashuri.

Dashuri për tokën,  
Dashuri lirie,  
O, kjo natë e ngrohtë, sa e bukur qenka.  
Ti duhej të vije!

**RRËKEJA RRJEDH NËN KAPOTË**

Rrëkeja rrjedh nën kapotë,  
Këmisha ngjitur kraharorit.  
Ushtari, bërë njësh me tokën,  
Shënon. Fryn era e dhjetorit.

Nga shqekëza nuk e heq synë...  
Ja, del e fshihet prapë «armiku»...  
Shënon, shënon e nuk merr frymë.  
M'e ftohtë dora se çeliku.

Rrufeja shkrep, po nis stuhia,  
Tërbuar i rreh brigjet deti.  
Ai shikon si merret vija,  
— Shëno më lart, ushtar Ismeti,

Që shpejt të ftohet plumbi i parë,  
Në gji të hasmit shpirtmizor,  
Po qe se rrugën do të marrë  
Drejt bregut tonë arbëror.

Rrëkeja rrjedh nën kapotë,  
Por ç'mund t'i bëj' vesa betonit!  
Ushtari bërë njësh me tokën...  
Dyshek kjo baltë e poligonit

VITET GJASHTËDHJETË

(poemë)

1.

Shekulli po kapërxente mesin e vet  
I kërrusur nën peshë ngjarjesh dramatike.  
Vjeshtë e viti 1960  
Gjethe e regjime rrëzonte tek ikte,  
Vjeshtë e zakonshme tiranase.

Gumëzhinin

Nga studentët e kthyer trotuarët.

Si fluturat,

Vajza të nxira në pushime plazheve  
Hanin akullore,  
U telefononin të lumturve.

10  
Urbanët, të mbushur me punëtorë të turneve,  
Ngadalësonin ecjen te Rruga e Dibrës...  
Gjithshka ishte e zhurmshme dhe e bukur  
Në prak të festave dhe të dimrit.

*103*  
Dhe ndërkaq, në heshtje,  
Në horizont të revolucionit, të botës sonë,  
Duke dalë nga thellësitë e mjergullta të vdekjes,  
Prapë qe shfaqur një kalë troje.

*104*  
Dhe vinin re njerëzit në ato mbrëmje tectori  
Në Bulevardin e madh, tek ktheheshin prej shetitjes.  
Në ndërtesën masive të Komitetit Qendror  
Gjithmonë e më vonë shuheshin dritat.

*105*  
Një kalë.  
Në barkun e tij mbi heshtat  
Ushtarët e moçëm s'mbështetnin mjekrat.  
Ish barku i tij sa salla Gjeorgjevska,.  
Ku Kongresi XX përbri tundte teserat;

Ish barku i tij i tmerrshëm.  
*Qindra Troja*  
Pregatitej të gllabëronte përmes flakësh e zisë.  
Përbri lokomotivës së hekurt të revolucioneve  
Nisi kursin troku i drunjëtë i tradhëtisë.

*106*  
2.

Partia e Punës dha alarmin e para,  
Alarmin e kalit që u shfaq kaq pranë.  
Ata qeshën dhe vrapanu përsëri në banketë,  
«*Cto vy!*»  
me gojën plot ata thanë.

Por ne nuk qeshëm,  
Ne faktet hodhëm.  
Diçka orgurzezë faktet tregonin,  
Ashtu si në mesjetë kur minjtë e ngordhur  
Rënjen e murtajës paralajmëronin.

Lëvizjen punëtore e kërcënonte një sëmundje  
E vjetër, por e tmerrshme:  
Revizionizmi.  
Qelqet e mëdha të kohës kjo flakë  
I çau si një krismë.

Ata e prenë të qeshurën,  
U vrenjtën;  
Ata na bënë shenjë të heshtnim.  
Kërcënimet e tyre vinin të shurdhëra  
Si bubullimat në prak të vjeshtës.

10  
Pastaj, kur panë se heshtje s'do të kishte.  
E lanë zemërimin të derdhej.  
Duke përplasur grushtin mbi tryezën e stepave,  
Uluritën papritur:  
«Mbledhje!»

3.

Një avion fluturonte në qiellin dimëror sipër maleve  
Drejt verilindjes. Drejt verilindjes.  
Re.

Re.

Re.

Shoku Enver Hoxha, mbështetur te dritarja,  
Vështronte pejsazhin e gjerë mbi dhe.

Shkrep i fundit i maleve u duk dhe një herë  
Nëpër mjergull,

sikur dha porosinë e fundit...

Pastaj toka të huaja.

Borë. Erë.

Avioni në djep furtunash tundej.

Ai nuk i hiqte sytë nga xhamet.

Re të zeza kudo: elektricitet, reshje,

Horizonte të zymta,

Heshta vetëtimash

Thyer aty-këtu si pas një përleshje.

Po shkonte drejt luftës.

Retë, që nxinin

Në horizonte, sajonin

kështjella,

llogore.

Avioni fluturonte nëpër barkun e qiellit

Mës shkretëtirës dimërore.

#### 4.

Në Moskë kishin rënë ngricat e para.

Mbërrinin me radhë delegatët prej gjithë botës.

Prapë salsa Gjeorgjevska ja.

Nën llampadarët

Reflekset e largëta të zjarreve të Trojës.

Nga muret vëshvronin portrete carësh,  
Tryezat të vendosura në formë katërkëndëshi.  
Busti i Leninit ngrihej përballë  
I bardhë,  
                me një shikim të rëndë.

Atmosferë e nderë.

Bota e tërë  
Mendjen atje e mbante ato ditë.

Ballë për ballë u gjendën në atë sallë  
Partitë, shtetet, tradhëtitë.

10  
Ra heshta e parë;  
Salla u drodh.  
Ata ulën kokët,  
                ata u kërrusën.

«*Cto vy!*» ata thirrën duke fshirë ballin  
E përgjakur nga ciflat e bombave të akuzave.

Ata tundnin flokët e bardhë,  
                tundnin mjekrat.

Ata fshinin djersët,  
                u binin gjokseve.

Ç'po ndodh? Si guxoni?  
Në veshë gjëmonin  
Këmbanat e vjetra të Kremlinit të Moskës.

5.

Ditë të mbushura me luftë, net të dendura me  
                intringa,  
Trokitje në mesnatë si në tragjeditë e Shëkspirit.

Në oborr të vilës së delegacionit tonë  
vetura të zeza

Ndalojnë.

Trokitje në errësirën e ngrirë.

Trokit e zgjo. Trokit e zgjo.

Me radhë..

Shfaqen në ZIM-a të zez ata.

Trokit e zgjo. Mikojan. Susllov.

Torez.

Natë e zezë,

hata.

Presione. Premtime dinake. Shantazh.

Kërcënime. Buzëqeshje. Shantazhe të reja

Dhe ashtu, siç vinin, iknin nëpër natë si nëpër ankth

Me ZIM-at e tyre të zinj.

Trokit e zgjo. Trokit e zgjo.

Era mbi tokë

Ngrinte dëborën dhe gjumin e vërtiste si e marrë.

Sa të rëndë e kishe këtë fund vjeshte, moj Moskë,

Sa të hidhur këtë acar!

6.

Një avion fluturonte në qiellin dimëror ngadalë

Drejt jugperëndimit. Drejt jugperëndimit.

Re.

Re.

Re.

Enver Hoxha vështron te zymtinë e maleve  
Të zbardhura nga dimri,  
jashtë, atje.

po Po kthehesin. Ishin të lodhur. Kolltukët  
E butë dhe konfortë të avionit herë pas here  
Zhdukeshin  
Dhe atyre befas iu dukej  
Sikur prapë çanin dëborën të zbardhur si ahore.

Ai vështron te trupin e paktë të atdheut,  
Fshatrat, brinjat e zhveshura me erë,  
Nga u ngjit kështu, si prej fundit të dheut,  
Fjala e lashtë se bota «qeder».

po Po kthehesin:  
Ai nuk i hiqte sytë  
Prej maleve të zbardhura, që nga retë dilnin  
Dhe nuk mendonte se në flokët e tij  
Gjithashtu ishin shtuar thinjat.

Dhe nuk mendonte se dhe ai do të zbardhej  
Gjithmonë e më tepër si këto bokërima:  
S'mendonte  
Se malet e larta gjithmonë  
Thinjen kështu  
nëpër stuhi,  
nëpër dimra.

Nëpër pyllin e pafund të antenave të hekurta  
 Stuhia e propagandës fryntë përmbi botë.  
 Kishte mbrëmje, kur  
 Më shumë lajme se ajër  
 Thithnin mushkëritë në atë dimër të ftohtë.

Në horizontet e ditëve të mbuluara nga retë  
 Dridhej fjala gërryese «përçarje».  
 Mbi ballë katundesh, mbi shqetësimë qytetesh  
 Një mjergull e bardhë varej.

Përmes mjergullës avionët venin e vinin,  
 Nga pesha antenat kërruseshin e gati sa s'binin.  
 Tradhëti, lëviz.

tradhëti, ulëri,  
 Në aeroportin Vnukovo,  
 n'aeroportin Orli.

«Prerje marrëdhënjesh Shqipëri-BRSS».  
 «Grindja me Kinën», «Prishja fatale».  
 Pylli i antenave gjëmonte e ulërinte  
 I qullur nën djersët e ftohta të ngjarjeve.

Bota nën flokë të shpupurisur radiostacionesh.  
 Kuaj trojanë me krahë avionesh.  
 Tradhëti, lëviz;

Tradhëti, ulëri

Në aeroportin Kenedi,  
në aeroportin Orli.

8.

Çdo ciklon ka një qendër që quhet «sy».  
Është syri i ciklonit si syri i ciklopit.  
Në synë e ciklonit, në ballë  
                                të furisë  
Ne u gjendëm ahere në atë dimër të ftohtë.

Kështu ishim gjendur një herë dikur  
Përpara sultانëve të tmerrshëm osmanë.  
(Mbi flamurin sovjetik kosoren e drapërit  
Si gjysmëhëne po e tundnin tradhëtarët.)

Në rrugët me shi të Tiranës,  
                                te xhamet  
Plot avull të kafeve,  
                                pas ndërrimit të turnit,  
Njerëzit bashkë me kafen pinin  
Nga ekspresi i kohës lajmet e fundit.

Nga Vlora po iknin nëndetset sovjetike,  
Ikte ambasadori, specialistët,  
                                si minj  
Të gjithë po iknin, iknin, iknin  
Me «pobjedat», me «vollgat» me ZIM-at e zinj.

Prapa diellit!

Kështu gjithmonë kanë ikur,

Duke menduar ardhjen, të gjithë njëlloj.

Kjo tokë asgjë nuk pësoi nga të ikurit,

Ashtu si nga të ardhurit asgjë nuk pësoi.

9.

Blokadë.

Këtë fjalë të rëndë kallkan

Nga humnera e fjalëve e nxori kjo dekadë.

Ne, që në shekuj me shumë fjalë u mësuam  
Të tmerrshme,

U mësuam dhe me fjalën blokadë.

Zona e naftës, si grua shtatzënë,

Dridhet nga dhimbjet,

gulçon gjer në re.

Nga uria e furrave, që është më e rëndë se e njerëzve,

Tymi i uzinave u dobësua, u zbeh.

Nga thinjat dhe rrudhat e kombit shumë herë

Çurk rroddhi gjaku i kuq tatëpjetë.

Por kurre s'na rroddhi kaq shumë djersë

Si këto vite gjashtëdhjetë.

Në lagështirë minierash,

Në puse, vinça, sonda, ara                              në temperatura furrash,

Ne ngjiteshim,

zbritnim,

pa pushim lëviznim,

Vagonët e ditëve duke shtyrë përpëra.  
Përpëra.

S'pyesnim për lodhje, për turne.  
Djersa mbi këngët na binte në dhjetor.  
Në Bulevardin e madh  
Kish dritë gjer vonë Komiteti Qendor.

10.

Çdo ciklon, kur vjen, shkatërron e prish.  
Erozion i lëvizjes.

Përmbytje partish.  
Tradhëti, ulëri,  
gulço gjer në re,  
Në aeroportin Orli,  
në aeroportin Burzhë.  
Salla Gjeorgjevska  
Riste kuaj të drujntë të rinj.  
Herë shfaqeshin ata si avionë reaktivë,  
Herë shndërroheshin në ZIM-a të zinj

Stuhi e propagandës vërvshëllente si e marrë.  
Partitë përqaheshin,  
Mijëra dezertonin.  
Kjo ishte sëmundja e ruazave të bardha,  
Leuçemia e tmerrshme e revolucionit.

Kjo kokë donte nerva të forta,  
Kur dallgët politike ngriheshin sa një mal,  
Kur poshtë vorbullave të gabimeve të vogla  
Mund të fshihej humnera e gabimit fatal.

Heshta vetëtimash na thyheshin mbi supe,  
Shkulmë e stuhisë në gjoks na godiste.

Larg,

Ylbere miqsh.

Ne çanim më tutje  
Midis Shillës imperialiste,

Haribdës revizioniste.

Bota nënë flokë radiostacionesh  
Netët e turbullta i gdhinte me zor.  
Ne qëndruam në mbrojtje të revolucioneve  
Të pamposhtur, heroikë, madhështorë.

Qëndruam  
Në Bulevardin e madh.

Përpara

Ndërtesës masive të Komitetit Qendror  
Mimozat prapë çelën.  
Nga gjithë ky dimër  
Ndër flokë veç mbeti aty-këtu ca dëborë.

11.

Cikloni kaloi, por bota nuk shtrohej;  
Lëvizja punëtore ngrinte kokë përsëri.  
Kështu ndodh gjithmonë:  
Pas përmbytjes blerojnë  
Pranë trungjeve të kalbur filizat e rïnj.

Feneri i komunizmit në Evropë s'u shua.  
Qiellin kinez përflakte revolucioni.  
Lokomotivat e revolucioneve nga treni i historisë  
Tradhtëtarët u përpinqën më kot të shqitnin.

Lokomotivat prapë lëvizën, duke tërhequr  
Me forcë titanike

vitet,  
dekadat.

Fishkëllima e tyre ngrihej madhështore  
Mbi horizontet e mjergullta.

mbi shantazhet,  
blokadat.

Të tërbuar, ata vringëllinin armët,  
Atomin, nëndetset, bakteret, zinxhirët.  
Atje ku ZIM-at e zinj s'bënин punë,  
Avionët «Antonov» nisin në errësirë.

## 12.

Një avion i çuditshëm papritur u ul  
Një mesnatë gushti në aeroport të Pragës.  
Rri si kokudhi në pistë.

Askush  
Nuk zbret nga mysafiri i zymtë i natës.  
Ç'është ky avion i vonuar?

Pse  
Dyert nuk hapen?  
Ç'pasagjerë do të ketë  
Brenda tij struktur mbi aparate elektronike.  
Ulisët dhe Menellajtë e shekullit të 20-të?

Drejt Pragës tanket rrëshqisnin nëpër terr.  
Një veturnë udhëhiqte atë mal me çelik.  
Drejt qendrës rrugën tankeve u tregonte  
ZIM-i i zi i ambasadorit sovjetik.

Si gogol mbi Evropë fluturon Jakubovski,  
Duke zgjatur kthetrat e përgjakura nga lart.  
Përpëlitet një zog në kthetrat monstruoze,  
Në kthetrat e tij

Praga e artë.

Fluturon.

Prapa vetes lë re dhe enigmë.  
Emri i tij në orët e lajmeve tingëllon ogurzi.  
E dëgjojnë pleqtë dhe pyesin nipat:  
Jakup-pasha?  
Nga doli ky pashë i ri?

13.

Flokët e shprishur të radiostacioneve s'ka krehër t'i  
shtrojë.  
Fishkellejnë, pliksen si gjarpérinj, tendosen pa  
mbarim.  
Retë me gjokset e grisura enden përmbi botë,  
Shqipëria Traktatin e Varshavës gris me rrëmbim.

Kështu i grisëm fermanet e sulltanëve  
Pa pyetur për vulat e arta,  
Për titujt e mëdhenj.

Prapë erdhi shtatori në rrugët e Tiranës  
Dhe trotuarët u mbushën të zhurmshëm si përrenj.  
Nga baret, ku pihet në këmbë kafe ekspres,  
Nga zyrat, nga korpusë uzinash e kantieresh  
Ky lajm mbi çatira qytetesh fluturoi  
Atje ku malet mbi kokë kanë erën.

Malet. Mbi hijet e tyre si hejbe  
Sa herë varëm shpresat,  
  vetëminë varëm:  
Varëm trastat e muajve,  
  të viteve dengjet,  
Fshatrat, krojet, nina-nanat e përrallat.  
Dhe ecëm në grykat plot jehona të shekujve,  
Gjersa mbërritëm këtu,  
  në kohën tonë,  
Kur, përbri maleve,  
  ngritën të pamposhturat  
Rrjeshta të uzinave:  
  malet e revolucionit.  
Mbi oxhakët e tyre, si mbi shkrepat e lartë.  
Retë e furtunave politike grisen.  
Fluturojnë në erë puplat e traktateve  
Të ndjekura nga stuhia e madhe leniniste.

22 PRILL

1

Postieri  
Gazetën e madhe të kësaj dite  
(Si një copë drite)  
Nëpër të çarën e derës e futi.

— Edhe sot  
provokacione:  
— Edhe sot  
Burrat me syze  
Për çarmatimin do grinden.

Por bota sot ka një festë të madhe,  
Por bota sot  
Në quell  
Boton fotografin' e Leninit  
Hipur në autoblindë.

Çuditeni?  
Lenini kësaj dite del nga gazeta,  
Zbret nga autoblinda  
Dhe, me kapelën shuk në dorë,

Hyn në shtëpit' e ulëta  
Të të gjithë proletarëve  
Të botës.

2.

Xhaxha Lenini erdhi  
Edhe në lagjen time.  
Plakat fshinin sytë e mallëngjyer,  
Eh, plakat qanin...  
Dikush mund të pyesë  
— Si është e mundur  
Që një i vdekur  
Të ngrihet nga mauzoleumi,  
Të flasë me të gjallët  
Si i gjallë?..  
Por bota u mësua  
Të mos çuditet me Leninin.

3.

Kështu pat ardhur  
(Kapelën e mbante njështur në kokë)  
Dhe u thosh grave që kërkonin  
  bukë për kalamajtë

Se dita e nesërme do të lindte  
Në çarçafët e pastër të socialismit...  
Në lagjen time  
«Socializëm» ish fjala  
Më e çuditshme.  
Plakat kuptionin parajsën

Dhe amëshimin e pafund të shpirtit:  
Gratë thoshin se socializmi  
Do të nxirrte ligje të rrepta për burrat  
që dehen

Dhe që i rrabin gratë  
Mbrëmjeve.

Atje,  
Në këshillin e lagjes,  
Shkonte Lenini dhe i sqaronte të gjithë  
Burrat dhe gratë e shqetësuara,  
Plakat  
Dhe vajzat e pamartuara.

#### 4.

Kishte dhe njerëz, që s'donin t'i besonin  
diellit,  
Ujit që pihet pas buke,  
Dritës që hyn në bodrum,  
Shiut që lan vijat e trotuareve,  
Stuhisë së revolucionit . . .

Këta njerëz  
I mori koha nëpër këmbë . . .  
Në ato kohëra të çuditshme  
Edhe ne  
Kalamajtë «e çmendur» të lagjes  
Vumë dorë  
Në rrotën e karros — histori.

5.

Vetëm një herë  
Në syt' Leninit  
Ne pamë lot.  
Një shoku ynë  
Në fushën e aeroplaniëve  
Pat gjetur një bombë...  
Dhe...

Lenini,

i mallëngjyer,  
tha:

«Kur të kthehem në mauzole,  
Do ta marr me vete  
Kujtimin e këtij arkivoli  
Të pafajshëm...»

6.

Kësaj dite  
Lenini del nga mauzoleu...  
Kapela e tij shuk  
Do t'u kujtojë të gjithëve  
Revolucionin.  
Dhe s'do të ulet Lenini  
Në kolltuqet  
E shteteve.

**KUR SHOH BOTËN NË SYTË E FËMIJËS**

*Nipit tim*

Kur shtrin duart e vogla për të përqafuar botën  
e madhe  
Sytë e zes të shkëlqejnë në fytyrëzën e njomë  
Si pikat vesës mbi petalet e luleve.  
Buzëqeshja jote është si rreze dielli  
Që nuk e di gjëzimin që u fal të tjerëve.  
Kur në krahët e mi hidhesh pa pushim,  
Kur në ballin e qetë si deti pa dallgë  
Të sajohen rrudha si të frynte era e mendimit,  
Unë e di se digjesh nga padurimi për të jetuar.  
Ty të pret një kohë e bukur dhe e shqetësuar.  
Buzët që s'kanë çeluar ende burbuqe fjalësh  
Do të thonë fjalë të reja, më të thella se tonat... .

**HERONJTE E VIGUT**

(poemë-fragment)

Gur e shkrepa se ç'ushtojnë,  
Ç'janë këta krushq, që po këndojojnë,  
Sa mir' kangës po ja thojnë,  
Kë vallë sot ata martojojnë?

Edhe Gjadri i tërbue  
Po gjimon tue gurgullue,  
Zhurmë e kangë i ka bashkue.  
Fort ta kanda me e ndigjue.

Le t'gjimojë sa të dojë,  
Gjadri i zi kurr mos t'pushojë,  
Se s'asht dasëm as gosti;  
Atje n'Vig mbrenda n'pusi,  
Tue prit'vdekjen nga çdo anë  
Këndojojn' trimat partizanë.

S'duen ket' jet ata me e lanë  
Një herë kangës pa ja thanë.  
Ndoci i vogël flet nji fjalë:  
— Të këndojm' dalë e ku t'dalë;  
Ditë e madhe na ka ardhë  
Sot me u nda me faqe, t'bardhë,

Faqebardh' para Partisë,  
Para shpisë edhe Shqipnisë.  
Tue u vra me arm' në dorë,  
Me u rrjeshtue ne me dëshmorë.

Nisja kangës, Hydajet,  
Kndo, Naim e kndo, Ahmet,  
Le të vdesim me gajret,  
Si na msoi me vdek' Perlati,  
Tym e flak' kur iu dogj shtati;  
Dridhi mal e dridhi kodër  
E la nam mbrenda në Shkodër. —

Çeta e vogël po këndon,  
Gjith pusia e dëgjon, .  
E dëgjon e ban çudi,  
A jan' njerz e jan' xhindi;  
Çka do t'jet' kjo farë e re,  
Që s'e tremb vdekja n'kët, fe?

Nuk jan' xhind, o kapidan,  
Por jan' trimat partizan',  
Jan' evladi i Partisë,  
Dritë e shpresë e Shqipenisë.

Sapo kanga ka mbarue.  
Ndoci i vogël n'kamb' u çue,  
Shikon malet an' për anë  
Një amanet don me iu lanë  
«Amanet, o mori male,  
Kur ushtria ktu të dalë,  
Shokve ton' ju me m'iu falë,  
Me iu tregue si kem' luftue,  
Si jem' vra, si jem' coptue,  
Rreth e rreth prit' ngujue.

Lamtumir' nana Parti,  
Jetën ton' ta falim ty.  
Kem' punue si na ke thanë  
E gja mangut s'kemi lanë;  
Deri ktu kem' ardh' me nder,  
Kshtu po ndahna edhe ksaj, herë.  
Po na vret plumbja e tradhtisë  
Për hesap të Gjermanisë,  
Porse plumbja s'na tremb ne,  
Se na ushqeve me ide t're,  
Ide t'Marksit e t'Leninit,  
Që a shpëtimi i gjith njerëzimit.

Lamtumir' për t'fundit herë,  
Edhe n'vorr ta dijm' për nder.

Lamtumirë, moj Mirditë.  
Gjaku yn' t'u baftë dritë,  
Na ke pritë e na ke qitë,  
Bukën para na ke shtrue,  
Bukë e kryp' çka ka qillue,  
Na ke la, na ke arnue  
Kmishat tonë laskarue.

Prej rreziqesh na ke rujtë,  
Ke ndihmues sa ku ke mujtë.  
Keq për ne pra mos të t'vijë,  
Se kështu burrave u ka hije:  
Fjala e folme në kuvend,  
La me gjak ma mir' ze vend.

Lamtumir' shok't e Partisë,  
Shok't e luftës e t'rinishë;  
Lamtumirë i bajmë shtëpisë,  
Nanë e motër, babë e vlla,  
Amanet mos me na qa  
Se n'Mirdit' ne kemi ra..»

**SHOTE GALICA**

Të gjithë trima gjokserreshkur,  
Burra të rëndë e ballëlartë  
Ty të kanë vënë në krye  
**Grua trime me nagant.**

Mes shtëpive, në qytet  
Të rrrethojnë shpesh xhandarë.  
Netëve ti zurret dhe bën  
Mbi katilët atentat.

Të rrrethojnë, të plagosin,  
Shëmbejnë shpitë kosovare,  
Lart në dhomat ti, e mbyllur,  
Në bedenë i kthen dritaret.

Pas të ndjekin nëpër male,  
Ti me çetën trokon larg.  
Si një kockë e brejtur hëna  
Zverdh e hollë përmbi mal.

Luftë në mal, prehje në mal,  
Shi dhe erë dhe shtegtime,  
Shkrepëtijnë patkonjtë dhe qiejt,  
Shkrepëtijnë pushkët, trime.

Qave burrin, qave trima,  
Lidhe plagë, të lidhën plagë,  
Sa e rëndë jetë e malit,  
Moj komitja me nagant!

Gjithë ndjenjat vajzërore  
Diku thellë i ndrydhe ti.

Përmbi kalë i ndjeve vitet,  
Në mes luftash me rrebesh  
Kali yt, trokon, trokon,  
Jelen zbardh mes jele resh.

Burrat ngjiten, lenë fshatrat,  
Lenë shtëpitë, luftojnë në mal,  
Pushkë e nxehjtë kudo vret  
O, Kosovë, o kosovar! . . .

**PËR ATA QË VIJNË NGA FSHATI**

1

Jam bir fshatari.  
Mos ma vini re, shokë,  
pse shpesh mënjanë rri i menduar.  
Në sytë e mi, me kohë, komisari  
ugare, vreshta, stërkala ka vështruar.

2

Sa herë bajonetën pastroj,  
më shkon mendja te plori...  
dhe rend nëpër brazda tarracash,  
në fusha, ku dhe natën kollitet traktori;  
dhe hyj në brigadën time të punës;  
hedh farë, vadit, prashit, korri grurë...  
Ahëre puth bajonetën, që më lidh kaq shumë  
me shokët, tokën bimët, me çdo gur.

3

*Sa herë* në marshime zë e bie shi,  
kuvendoj me pellgjet, që krijohen në çast.

A bie në kooperativë shiu tani,  
tani që tokën  
s'e pret dot as me shpatë?  
Tani që do fillojnë mbjelljet prapë?  
Dhe ujët e këtyre pellgjeve s'di  
si ta mbledh dhe ta dërgoj ,në fshat.

4

Sa herë që marr bukën në duar,  
dëgjoj fëshfërimën e kallinjve kokulur në arë.  
Si ata qofsha gjithmonë,  
në klasë, në fushë, në poligon —  
midis shokëve të dalluar ushtarë.

5

Sa herë në radio dëgjoj  
reportazhe nga puna e aksionistëve të rinj,  
përpinqem mos dalloj  
emrat e bashkëfshatarëve të mi.  
Dhe kur gazetari nga ata s'ka takuar asnje,  
më duket se shkrimi s'është kushedi çë.

6

Sa herë mushkën e repartit ngarkoj,  
kujtoj tërkuzën  
në supet e motrës...  
Lexoj në sytë e saj të thellë si pus  
se si 6 Shkurti, andej, si erupsion,  
e nxori revoltën.

Dhe gjithshka të vjetër, barbare përbuz  
e ca fjalë prush të kuqe  
në letër shkruaj për motrën.

7

Sa herë jam në vendrojë,  
në sektorin e vrojtimit fut dhe fshatin tim,  
me shtëpi, me ara, me radio, me traktorë;  
dhe ndjej që guximi ma ndez kraharonë.  
Gjithshka më e shtrenjtë bëhet ahere për mua.  
Dhe më shfaqen pranë njerëzit që aq shumë i dua

8

Jam bër fshatari,  
Mos ma vini re, shokë,  
pse shpesh mënjanë rri i menduar.  
Në sytë e mi, me kohë, komisari  
ugare, vreshta, stërkala ka vështruar.

**POEMË PËR SEKRETARIN**

(*Mësuesit dhe shokut tim të paharruar.  
Ptolemeut*)

1.

Syrin e kishte të ëmbël, të mprehtë.  
Mendimin të qartë,  
Vështrimin të thellë,  
Urdhërin të prerë,  
Fjalën të urtë, të zjarrtë.

2.

Jetën?  
S'po ndalem në hollësi,  
Por di që nga ideologja dhe shpirti ishte proletar,  
Di që fushat e Elbasanit plot me vesë,  
Vargjet kodrinorë të Shpatit, Bërzeshtës a  
Dumresë  
Dhe po ashtu majaf pa mbarim-malet,  
E gjer atje ku Shkumbini ndalet  
E dielli

Ujrade të kaltra u falet  
E quanin  
S E K R E T A R.

3.

Dhe ne ashtu e quanim dhe pa fund e donim,  
Në orët e lira drejt tij rendnim,  
**Gazmorë**  
Përqark i qëndronim,  
Se fjala e tij  
Si zjarret partizane na ngrohte prorë,  
Se bukën të misërt e hante porsi ne.  
**Sepse**  
si ne  
netëve,  
majave,  
ndën një kapotë  
Gdhihej mbi borë.

4.

Në sulme,  
Ndër të parët,  
Në krye ishte pérherë,  
Në térheqje,  
Ndër të mbramit, i fundit fare;  
Nga fjal' e tij  
Dhe shkrepat merrnin zjarre  
E zjarr  
Dhe fushë e gjerë.

5.

Si në pëllëmbën e dorës të ardhmen e shikonte  
Dhe shpesh për Shqipërinë na fliste:  
«Ç'ka qënë, ç'është e ç'do të jetë!»  
Ne të etur e dëgjonim sa herë që bisedën niste.  
E, ndërsa fjala merrte krahë e fletë,  
Në bebëzat tonë rritej gjëzimi,  
Se ndryshe  
Njëmijë herë ndryshe  
Nga Rilindasit e mëdhenj — Samiu e Naimi.  
E përfytyronte ai  
Shqipërinë socialiste.

6.

Dhe ashtu me të  
Ne shkelëm  
Përmbi Dumre a majat thikë të Çermenikës,  
Përmbi Bërzeshëtë a grykat hon të Tomorricës  
Dhe prapë me të,  
Në netët sterr a ditët plot rrebesh,  
Betejash shesh më shesh  
Me të marshuam  
Nga Mokra e Gora, mbi Shpat a Martanesh.

7.

Por një ditë me mjegull,  
Ah, një ditë,  
Kur rreptë u derdhëm mbi hordhitë,  
E Pojskën mbuloi zjarri,

Na humbi ne nga sytë  
Sekretari,  
Ai që kurrë s'qëndronte  
Në vijë të dytë! . . .

z

8.

Dhe ne e kërkua, por s'e gjetëm, s'e pamë. . .  
Nga dhimbja zëmrat na u vranë  
E n'atë dhimbje i thirrëm e i thirrëm plot zjarr:  
— Ku je, o Ptolemeu i ynë?  
Ku je o shoku ynë sekretar? —  
Po zérin s'ja dëgjuam,  
Veç Malet,  
Në emër të tij,  
Njëzëri ushtuan:  
— Këtu në vijë të parë!

9.

Dhe ne në kërkim u endëm mbi ato maja  
Dhe prapë i thirrëm.  
Ai s'na u gjegj;  
Po në emër të tij sërish gjëmuani  
Kodrina e pllaja e brigjet gur:  
— Ai është këtu! Midis jush, midis nesh  
FLAMURI!

10.

Por ne as ata s'e gjetëm,  
Atëhere  
Mbi qytetet marshuam  
Dhe prapë dëgjuam nér barikada:

— Këtu, midis jush, përsëri  
Në eskadrone-brigada,  
Këtu ku fund po merr nata  
Është dhe ai!

11.

Dhe, thonë,  
Të nesërmen n'agimin tonë të ri,  
Në agimin tonë aq të pritur,  
Me diellin ish shkrirë  
E bashkë me rrezet  
Mbi tòkën e dashur  
Mbi dhenë e përgjakur  
Kish zbritur!

12.

Po ne në batalion  
Nuk e pamë sekretarin tonë.  
Veç thonë.  
Më vonë,  
Në ditët plot hare,  
Kur litari shtrihej e tokat maste në Myzeqe,  
E kishin parë,  
Dhe prapë në Goré  
Kur shoku Enver  
Tapitë bujqërve u kish ndarë.  
Thonë, edhe ai,  
Gazmor, midis turmës  
Qëndronte atje...

13.

Dhe po ashtu,  
Pranë shokëve, si më parë,  
Në Maliq e Thumanë,  
Selitë, Va-Dejë a Bistricë,  
Në ditët me diell a me ngricë,  
Thonë: e kanë parë!

14.

Po dhe atje  
Ku ligjet e kanunit muarën flakë,  
Ku llampa u montuan  
A malet u taracuan  
Pak nga pak,  
Thonë: ndodhej edhe ai i pandarë!

15.

E përsëri,  
Si gjithnjë  
Në zheg dhe acar,  
Edhe në brezin kufitar,  
Ku armiku  
Me barot e zjarr  
Loz me dredhi,  
Thonë: i pafjetur përkrah popullit ushtar,  
Në vijë të parë  
Qëndron edhe ai!

**O TALO, MOTËR!**

Eja motër, eja nën pjergull!

Babushit të lodhur që kthehet nga kopshtet t'i vemë në  
prehër.

Të fshijë me dorë rrudhat e ballit,

Kujtimet dhe zënkat nën mjekër.

Eja Talo t'i dalim përpara tek kumbulla e vjetër.

Gishtrinjtë e tu më mbetën flokëve, në buzë.

Ledhat e tua i ndjej dhe tanë që jam rritur.

Imazhi yt çan vite, çan mjergull,

Mbi supet e tua kërcej e qesh, i mitur...

Sot ditët janë të ngrohta, me zhurmë e gaz rrjedhin

Dhe në Dhërmin tonë, buzë Jonit,

Nën portokalle vajzat tok shaminë e bardhë dredhin,

Shaminë e zezë e shkulën nga zëmra e nga flokët,

O talo, motër!

**NJË KANGË E RE SOT NISI FLUTURIMIN**

Një kangë e re sot nisi fluturimin.  
Partia  
Diell rri tue shkëlqye.

Për ata lotë të ndritshëm ngazëllimi,  
Që të bulojnë, shoku Enver, ndër sy,  
Kur lule të dhurojnë fëmijët tanë,  
Për atë nderim ndaj shamizezës nanë.  
Që për lirinë  
Të vetmin djalë ka dhanë,  
Për dashurinë e thellë që ke për ne  
Dhe jetën tonë të lumtun e të re.  
Për atë besim  
Që n'forcat tonë ngjall,  
Për frymëzimin me qëndrue në ballë,  
Për atë jehonë  
Të zemërimit tand të shenjtë e fshikës  
Kundër kujdo, që shkel të drejtën tonë,  
Vijmë sot tek ti  
Na gratë e Republikës.

S'dëgjuem na predikimet nga amvona  
Për lutje,  
Për nënshtrim  
E për shenjtorë,  
S'u futëm skutash malet kur gjëmuen.  
Me armë në dorë  
Përpara shkuem, bashkue fort ndër kolona,  
Kur lart nga maja shkrepash na urdhënuen  
Për sulm  
Të shtrenjtët komisarë — shqiponjat tona.

E kur  
Atdheu i lirë kërkonte djersën tonë,  
Nuk ndejtëm me qëndisë, me ba azhur,  
Por, si gjithmonë,  
Na u radhitëm nën flamur  
Dhe Republikën ngritëm gur mbi gur.  
Në fushë.  
N'uzinë,  
Në hekurudhë  
Nga ftyra zhdukëm një nga një çdo rrudhë.  
Kuptuem na, shoku Enver, nga fjala jote:  
Nuk jemi plaçkë për derë të botës.  
As shërbëtore, as lojë,  
Me një krah shqipja s'mund të fluturojë.  
U ndezën zemrat tona për partinë.  
Muret rrëzuem,  
Kuptuem na të vërtetën:  
Se jemi njerëz,  
Përtërijmë na jetën,  
Krijojmë ma t'madhen pasuni — njerinë.

## Poshtë

Jeta në kuvli!  
S'asht andrra jonë  
Me u ngrohë vec mbi mangall,  
Te dera e oborrit me shpërrallë,  
Me kuvendue vetëm për shtiza e gjellë.  
Mësuem nga ti  
Kazmën në tokë me e ngulë ma thellë, -  
Drejt horizontesh sytë me i sjellë,  
Ma nalt me e ngritë flamurin tonë të ri;  
Mësuem  
Jo të kërkojmë mëshirë,  
Me lotë të ngallim dhimbsuni,  
Por të luftojmë me qenë njerëz të lirë  
Me duer të arta e me ballë të dlrë,  
Me zemrën komuniste zjarr në gji.

Edhe n'mos e kuptoftë ndonjena nesh  
Fjalën emancipim,  
Ajo e di se ç'don të thotë rrebesh,  
Që krejt rropos çdo landë në kalbëzim.  
Po shkrihen ujnat ngri kallkan.  
Thellë në krahnor na ndjejmë si gurgullojnë  
Rrëketë, që do të derdhen me poterë.  
Lyp rrugëdalje  
Ky vullkan.  
Ruenju, atëherë,  
Rriqna konservatorë e burokratë,  
Që nuk dëgjoni malet si gjëmojnë,  
Që nuk dëgjoni zemrat si këndojojnë,  
Si luftëtaret e së resë sulmojnë,

Të gjithë ju, pra, të mykun prapanikë,  
Mendoni mirë,  
Rradhituni me shokë:  
Syut të partisë nuk mundet kush me i hikë,  
Ligjit të saj,  
Që kryet ta shemb përtokë.

Do zhyten thellë në detin e harresës  
Fjalët e fatalizmit,  
Të dëgjesës:  
— Na pastë le vajza, o grue, me baft!  
— Varet prej teje, burrë, fati i martesës. . —  
Mjaft!  
Vajza do rritet  
Jo me u përulë, me qa, me puthë altar,  
Jo me u ngarkue si kafsha me jullar <sup>1)</sup>),  
Jo t'i dërgojë jastekë, komô e raft  
Dhandrrit  
Për pajë të majme lakmitar. . .  
Në punë  
Përkrah me djalin do kalitet,  
Koha do shkojë e s'do ta plakin vitet.

Nejeta na u zgjat, shoku Enver,  
Se jetë nuk asht një jetë kalue n'errsine,  
Njeriu rron kur dielli zemrat ndrin;  
Mes katër mureve, me krye në qyshk,

---

1) Kapistër

Veniten ndjenjat,  
Zen mendimi ndryshk.  
Na s'jemi ma kryeulta.  
Të gastarta.  
Partia e Punës  
Kjo shqiponjë e gjallë,  
Shtabi i çeliktë, që ty të ka në ballë,  
I revolucionit timonier,  
Me vlleznit tanë na bani t'barabarta  
Dhe na e drejtoi  
Kurrizin tonë me plagët shekullore,  
Partia na tregoi  
Rrugët që shpien vetëm në fitore.  
Dhe u sulëm na  
Në jugë e në veri,  
Dhe morëm vesh ma mirë  
Se asht e madhe kjo Shqipni,  
Se asht e hijeshme kjo Shqipni,  
Se e pathyeshme asht Shqipnia e lirë.

Çdo grue, që u ngrit nga balta n'shkamb të lartë.  
Çdo vajzë shall-e-sykaltër zemërzjarrtë,  
Çdo plakë nga motet **krrusë e synin flakë**  
T'uron  
Si mund t'urojë një bijë për babën.  
Që jetë i dha,  
E barazoi me shkabën,  
Si mund t'urojë një motër  
Për vllanë e vetëm rritë pa bukë n'një votër,  
Që jetën bashkë e çuen me zgripa  
E bashkë n'marshimin partizan kënduen

Të shtrenjtën  
«N'ato maja rripa-rripa»,  
Si mund t'urojë pér djalë  
Një nanë,  
Që ma fort kobe sytë në jetë i panë,  
Por vdes e qetë  
Se ka kë pas me lanë.

Ma i bukuri urim,  
Tani që i mbushe gjashtëdhjetë,  
Asht besa,  
Fjala jonë betim:  
Përherë trimnesha të lundrojmë në det,  
Me tharm të ri t'i mbrujmë  
Fëmijët  
Që në sisë,  
Letrat e tua, shoku Enver, t'i ruejmë  
Si komunistët emnin e partisë,  
Me ty na ballë t'i bajmë çdo prove.  
Një kazmë edhe një pushkë të mbajmë në duer.  
Gazmore lart të ngrejmë me hove  
Këtë foshnje të shëndetëshme  
Flamur.

?

**G J U R M E T**

Sa rrugë e shtigje prapa nesh kan' mbetë,  
Sa vite porsi andrra fluturuen!  
Si rrjedha e lumit ikën ti, o jetë,  
E len në shpirtna tonë kaqë gjurmë.

Çdo gjurmë asht një andërr gazullore,  
Një shpresë e hovshme e rinis' së flaktë.  
Aromën ka të luleve malore  
E shkëndijat e pasionit ma të zjarrtë.

Këto gjurmë janë vetëjeta jonë,  
E djeshmja, që nuk kthehet kurrë ma...  
Sa shum' kto gjurmë sonte po më thonë,  
Çdonjana një kujtim më sjell pa dà!

E si n'vegim kalojnë para vitet  
E gëzimet e idhnimet, që më brenë.  
Dy sy më qeshin, një fytyr' venitet,  
Një tjetër si agimi vezullon!

E ngjarjet porsi gurët rrokullisen,  
Koha e vështirë e luftës para m'del...  
Heroj legjendash në betej' s'u nisëm,  
E s'qem' kalorësa, që vrapuen n'dué.

Në atë të kobshmin vit tridhjet' e nandë  
Na ishim pa lshue shtat, ende fëmij',  
Por thik' në zemër na u ngul hapi i randë,  
Si burra t'pjekun t'deshëm, o Shqipni!

Fletoret deri ahere armë kishim,  
Mësimet qen' beteja aher' për ne,  
Por bankat një nga një ne do t'i lishim  
E kishim me fillue nji shkoll' të re.

Të gjith' «shkëlqyeshëm» s'e kaluem provimin  
E ndonjë nesh bile në klas' pat mbetë,  
Por mësuesi ynë s'e pat humb' durimin  
Dersa na nxori n'udhën ma të drejtë.

Asnjë prej nesh nuk qe hero i lemë,  
Por si paçavër tej e flakëm frikën  
E trima të paepun veten ndjemë  
Dhe kur ta shpraznim pushkën fare s'ditëm.

Sa rrugë e shtigje prapa nesh kan' mbetë,  
Sa vite porsi andrra fluturuen,  
Porse për ne s'kalove kot, o jetë,  
Na ty çdo orë dhe çdo ças t'jetuem.

E n'rrjedh' të kohës qemë ne kalitë,  
Në gjeratore u mësuem t'notojmë,  
Në majat ma të nalta qemë ngjité  
Edhe pse s'dinim mir' të fluturojmë!

*Tiranë, Nandor 1958*

**PRANË NJEREZVE**

Kam shkruar për hapësirat e vezulluara nga rrezet,  
Për diellin pranveror, për lulet  
Dhe bimët,  
Për netët vjeshtake plot fllade të freskëta,  
Për dëborën e beluztë,  
Për erërat dhe stinët.  
Më ka prekur në shpirt thellë natyra,  
Relievi i Shqipërisë i gjelbëruar  
Me pyje,  
Thëllëza e fushës dhe dreri  
Dhe ajri i kulluar nën halëza pishe.  
Por a mund që të shpreh me ëmbëlsi poetike  
Tërë dashurinë që kam  
Unë për tokën,  
Duke folur vetëm për bukurinë ekzotike,  
Për ylberët dhe perëndimet.  
Për lisat dhe shqotën?  
Por unë s'jam i verbër të mos shoh,  
Krahas luleve,  
Krahas krahëve të fluturave dhe xixëllonjave të arta,  
Si ngrihen gjigante me shkëndijat e furrave  
Oxhakët e uzinave tona

Dhe furrënaltat.

Por unë s'jam i shurdhër të mos ndjej, kur agon,  
Zhurmimin e kantiereve të punës,

Sirenat,

Karvanet e drithit dhe maqinat me krom

Krahas zogjve dhe pyjeve

Që i flladitin pranverat.

Ndaj më duhet gjithmonë pranë njerëzve

Të rri,

Pranë tokës dhe jetës

Që në thellësira të futem,

Pranë hallevë të popullit dhe gëzimeve të tij.

Un' bir i tij që me nderim

I përulem.

**KËNGËT E VENDLINDJES**

(*Kumuri e Elbasanit  
këndon herët në mëngjez...)*

Edhe mbitë ju si lule të egra,  
Shtrirë nëpër malet pa kufi,  
Herë nga një shpirt i copëtuar,  
Herë nga një gotë me raki.

Nën ju u tund dhe djepi im,  
Dhe u rrita unë nën ju,  
Rrodhën lotët, dasmat, qanë zemrat,  
Rrodhën dhjetëra breza nën ju.

Kush ju dha kët' madhështi të rrallë,  
Këtë forcë nga e morët ju,  
Kush juva tregoi rrugën vallë,  
Që i ratë botës kuturu?!

Un' s'do mundja tē këndoja kurrë,  
Porsi ti, e émpla kumuri,  
Un' s'do mundja tē buçisja kurrë  
Si buçet ti dimrit, moj selvi.

Por s'ka gjë, unë gjithnjë do mbetem  
Nxënës ballërrudhur; por nuk di,  
Cili ishte ky mësonjësi i rrallë,  
Që ju lindi juve nuk e di.

Ju buruat nga një mij' burime,  
Rrohdhët bashkë si një lum' vigan,  
Gurgullima juaj drodhi zemrat,  
Turbulloj ndjenjat anembanë.

Nën ju do doja ta çoj jetën  
Si një zog i lirë gjithnjë,  
Nën rrjedhjen tuaj t'i mbyll sytë,  
Dhe pastaj tē fle nën një selvi,  
Nën këngën tënde, kumuri . . .

**D R I T E**

Brinjët malësisë i pat' kafshuar  
Terri i netve të acarta...  
Nga drita hijet janë tmerruar,  
Tek ngjitet bjeshkëve të larta.

Do të fryjnë erërat e maleve  
nëpër telat-artere të malësisë  
e, si me një lahutë vigane,  
lavdinë do t'i këndojnë Partisë.

**NUK MË LE BORA TË SHOH**

Nuk më le bora të shoh  
Çatitë e kuqe dhe pemët e zhveshura,  
Por ndjej si nën të  
Lëviz pranvera.

Flokët e borës  
Bien e shkrijnë në qepallat e mia,

Kaq lot të bukur,  
Kaq lot të bardhë  
Mund të pikojnë vetëm nga dashuria

**ENDRRA E DESTANIT**

1

Ka shkelur shumë rrugë Destani,  
Destani që ka lindur buzë Drinit,  
Që ka gdhendur gjithë jetën gurë mali  
Që ka çarë biloqe graniti,

Që ka ngritur ura druri e betoni  
Mbi brigjet e thepisura të lumenjve  
Që të vejë kudo revolucioni,  
Që të jenë njerëzit pranë njerëzve.

Dhe atje ku është shfaqur Destani me shokë  
Udhëtarë ka thënë —  
Së shpejti një urë lumi do të shohë  
Një urë të fortë e të gjërë.

2

Buzë Drinit, në rërën e imët  
Është shtrirë e fle Destani...  
Valët i lëpihen tek brinjët  
Dhe shkumbën lënë tek zalli.

Po Destani fle qetë-qetë  
Pranë zukamës së rëndë të ujrave,  
Atje në rërën e nxehthë,  
Nën hijen e panjave e bungave.

Sepse Destani ka lindur buzë Drinit  
Dhe Drini e ka vënë në gjumë  
Kur nëna prashiste në arën e misrit  
Dhe s'i mbetej kohë për ninullë.

3

Fle Destani...  
Më tej turni tjetër  
Betonon këmbën e një ure,  
Atje ku përplaset dallga e egër  
Dhe gërvisht brinjët e një lundre.

Flet Destani... dhe sheh në èndërr  
Urën që ka lidhur tok  
Brigjet që të ndara tërë jetën kanë qënë,  
Të ndara që kurse ka lindur kjo tokë.

... Dhe sheh Destani maqinat e rënda  
Si kalojnë mbi urën e tij  
Dhe gjaku i ndizet ndër rrëmba  
Dhe qesh në gjumë si fëmijë...

D R I T È

Sonte s'dua tē fle, jo nga marazi i dashurisë si Milosao,  
Që mbeti nē netët e gjata magjike me ēndrra dashurie  
nē peisazhin baritor.

Sonte vërtiten pëllumba tē bardhë drite  
Nën një qiell tē gjerë e tē kaltër tē dritës;  
Fëmijët nē rrugë trokasim duart pér ardhjen e zambakut  
tē kuq;

Nën nat tonat ndezin globin e dritës sikur ndezin një hënë;  
Vajzat nën shtylla grumbuj-grumbuj këndoijnë këngë;  
Në brigje, nën shtylla, mbi shtylla, nën dendësinë e  
dritave ndizen këngë.

Sonte jam me ta  
Dhe do jem me ta.

Sonte me fëmijët nē rrugë trokasim duart,  
Sonte me nën nat tonat ndezim nē dhomë hënën,  
Sonte me shoqet, nën shtylla, këndojmë me ison e  
krahinës

në brigje, nën shtylla, mbi shtylla.  
Gjumë s'më zë nē peisazhin e ri tē dendur tē dritës.

**MUJO ULQINAKU**

Ç'janë ata që nxijnë detin?  
E dëgjon, nëno, tërmelin?  
— Jan' hordhitë e dushmanit,  
Për t'i vënë zjarr vatanit,  
O biro!

— Ç'janë ata këmishëzez,  
Që po vijnë aq serbes,  
Me ca pupla si këndez,  
O nëna ime?

Ata janë mizërira,  
Që po vijnë me zinxhira,  
Të na lidhin këmbë e kokë,  
E ta kthejnë varr' e gropë  
Çdo luadh, çdo fushë e pyll;  
Do nxirosinë çdo yll!  
Pa do mbushin me kufoma,  
Me kufoma, ah, të njoma  
Çdo kodrinë e çdo hendek  
Mal më mal e breg më breg.

— Zjarr nga deti, zjarr nga qielli!  
Nëno, u sterrua dielli!

\* \* \*

— Durrës ty, o Durrës plak,  
Hasmi po të shkel në prak,  
Populli u mbyt në gjak!  
Ç'po lëfton një ulqinak!  
Lëfton djali, lëfton plaku  
Gjer në gju na vate gjaku...  
Bjeri, Mujo Ulqinaku,  
Për liri!

Lufton populli i arbreshit.  
Si dikur me pallë sheshit

Për Shqipri.

Thérret Guxoni: *Mamma mia!*  
Ç'burra paska Shqipëria!

Telegramet ven' e vijnë  
Nga Londoni në Athinë,  
Nga Belgradi në Amerikë,  
Nga Azia në Afrikë,  
Nga Parisi gjer në Moskë:  
Ç'po luftojnë gegë e toskë  
Për një truall, për një prak,  
Lahen rrugëtë me gjak!

Kush lufton ashtu më këmbë?  
Kush ha hekurin me dhëmbë?  
Janë trimat shqipëtarë,  
Që po heqin zorrët zvarrë!  
Të tradhëtuar nga një mbret,  
Q'u degdis për në kurbet!

Është Mejua, një kapter,  
Që lufton e vdes me nder!

Dhe ja plumbi i mallëkuar,  
Tejpërtej në kraharuar!  
Ç'na u mbyt trimi në gjak,  
Për një truall, për një prak.  
Nëna me të madhe qan,  
Kur sheh shtrirë atë luan:  
— Gjirin ta kam bër' hallal,  
Xhan o shpirt me yll në ballë!  
Ti m'u vrave për liri,  
Ndaj të qan një Shqipëri,  
Bir o bir, si lumthi ti!

I RILINDURI

Si fes i bardhë atij i duken flokët,  
Parmenda e kohës hapi brazda shumë;  
Përgjigjet (kur për moshë e pyesin shokët):  
«Dy herë linda, ja, këtu mbi lumë,

Një herë kur më polli nëna e vuar,  
Një herë tjetër kur lindi Partia.  
Dy nëna trime më kanë mëkuar  
Me shpresë plot e ëndrra me mijë.

Si mal me borë koka ime duket,  
Po zemrën unë e kam njëzetvjeçare!  
Dikur në jetën time vojtja futej,

Si krimb përbuzja hynte në damarë...  
Njeri jam sot! S'përulem, s'vuaj, s'lutem,  
Se fatin tim në duar e kam marrë».

VAJZA E LABĒRISĒ

(Ligjërim për Zonjën Çure)

Zonjë o zonj' e zogjëve,  
Labe e vogël lugjeve,  
Këmbë-zbathur suferinë,  
Trëndelinë në lëndinë,  
Loje larg pekuleve,  
Zonjë o zonj' e luleve!

Moj zonjëz e yjeve,  
bukurez' e pyjeve,  
Ligjëroje ligje labe,  
Ëndërroje shtigje shkabe,  
Brigje përtej brëngëve,  
Zonjë o zonj' e këngëve!

Zonjë o zonjëz e Agimit,  
Vëngim e buçim shpëtimit,  
Ligja-ligjën rrökullis,  
Rob nuk rron i Arbit fis,

Frym' e frymëzim i trimit,  
Zonjë o zonjëz e kushtimit!

Zonjë e kapedaneve  
— Motra! thirre.staneve  
Kush është trim o le të dalë!  
Me shoqet rrëmbim e valë  
Re rufe tiranëve  
Zonjë e Partizanëve!

Moj Zonjëz e Çetave,  
Zvarrë mes shigjetave,  
Çet' — rrethosur, vet-gjakosur,  
Nxorre tej shok' të llavosur,  
Ball i barikadave,  
Zonjëz e Brigadave!

O Zonj' e fitoreve,  
Tribun i dëshmorëve  
Ndrite flin' e ndeze flagë,  
Nderin jet' e lirinë tragë,  
Krah për shqipe fluturimit  
Zonjë o zonjëz e Çlirimit!

Tiranë 1958

**UDHËT DO TË ZGJATEN...**

*(Komunistes Shkurte Pal Vata)*

1.

Ajo ra;  
Në sytë e njomë një vizion i moçëm  
Nga viset e saj të largëta,  
Një vezullim shkëndish prej diellit të sotshëm  
Në sytë e saj.

Shkurtë,  
Ti fabrikave, tarracave, rrugëve të reja...  
Në gjirin e ri u bëre vend!  
Le të vijnë poetët në gjak të ngjyjnë penat,  
Fëmijët të mbledhin lule  
Hapësirave të shpirtit tënd.

2.

Ajo ra në hekurudhë mbi trase,  
Mbi të dherat u rrëzuan të rënda e të lagura;

Rrjedh në ballë djers' e ngrohtë  
Dhe plagët i janë të përgjakura.

Në sytë e Shkurtës,  
Si në një burim alpin,  
Panë ditën kur u prish çdo fejesë,  
Ditën kur s'e mbysnin më rininë  
Në liqenin e errët të natës së zezë,

Panë ditën e ardhjes në hekurudhë...  
Gjaku i Shkurtës mbi tërë këto ditë binte,  
Dhe në shaminë e lidhur në gushë,  
Edhe nëpër «S»-të aksioniste.

Shkurtë,  
Ku e gjete ti guximin  
Për në të përpjetën e zemrave,  
Për në të përpjetën e viteve?  
Në rënjen tënde dëgjojmë rrapëllimën  
E kohrave të përbysjeve dhe të ngjitjeve.

### 3.

Dhe ti më fanitesh  
Me krahët të zgjatur që nën dhe,  
Si dy shina hekuri për në malësi,  
Që në trojet e lashta të rendë botë e re,  
Që atit t'i lidhësh tënden shami.

Hekurudha pér në jug drejtar,  
Ku do rendin karvanet e ditëve të ardhme,  
Karvane me djersë e përpjekje ngarkuar,  
Me trëndafila e grunja të larme.

4.

Ajo ra,  
Na u bë se drejt saj u zgjatën udhët;  
Udhë tē sambaruara, pa baltë e pluhur,  
U zgjatën si duar dhe e morën Shkurtën  
Ndër shtigje tē reja e tē panumërtë.

Udhët u zgjatën  
Dhe në shtegëtimin e gjatë  
Anembanë nga Bistrica në Drin,  
Ajo si Rozafa e legjendës së lashtë,  
Çdo vepre në atdhe do t'i falë rininë.

5.

Udhët do tē zgjaten  
Kohrave dhe shekujve duke shtegëtar...  
Por kur tē vijë i ëndrrave komunizmi  
Do tē ngrihet Shkurta e menduar,  
duke shkundur pluhur heroizmi.

Do tē ngrihet  
Në angullimë do t'i shfaqen viset veriore:

Supet i vë Rozafa baltës së vjeshtës së tretë,  
Shkurta do çelë sytë si në një èndërr mëngjezore,  
Do gjendet nëpër këngë të larta sa bjeshkët  
Përpjetë.

**KUDO VLON KANGA...**

Valbona shushurin e Dragobia  
Kreshtat shpërthen t'këndoje epikën tonë,  
Malet kokë m'kokë dëgjojnë çfarë thotë Partia.  
Ja... motet derdhen krepash plot jehonë. —  
Të zezat krejt copëtohen, vetë epika  
E t'zjarrtave kryengritje i shpartallon,  
Të bardhat i ruen t'gjalla Republika,  
Me to lavdinë Atdheut ja këndon.  
Jo, s'qenkemi të vegjël as jetimë!  
«O shoku Enver, na ke 200 milion...»  
Shpirti i malësorit flet porsi ushtima  
Që vetë Valbonën me madhni gufon.  
Nuk jem' të vegjël, na ka rritë Partia,  
Hutat e moçme krejt na i ka rinue;  
Qinda grykash janë — një grykë sa Dragobia, —  
Le të guxojnë anmiqtë me na kërcnue.  
Malet e kreshtave janë të lirisë,  
Kudo vlon kangë e socializmit,  
Çdo strofë një epope në gojë të dritës.  
Askush s'e ndal betejën tek përleshjet,  
Gjithkush krahët ka hedhë n'revolucion;  
Malet qesin bejleg kush ma fort ndeshet

Me t'vjetrën zhig — ma parë kush e varron.  
Dialog i rrallë; kurrë shekujt s'e kanë njohë;  
Partia flet, me të shoku Enver;  
Epika rritet, malet ngroh e ngroh  
E u hedh mbi shpatulla mijë ylberë.

**RAPSODI BREGAMATASE**

(*Për ditën e inaugurimit të kanalit  
të madh vaditës.*)

Tinguj shpérndan mbarë fushës çiftelia,  
Zejmeni pret malësorë e mirditorë,  
Si asnjëherë çohet me fund dollia,  
Partisë i falen me zemër në dorë.

Në breg të Matës ngritë asht çdo katund,  
Stolisun janë pér festë me gra e burra.  
Kanali shtrihet thue pa anë e fund,  
Pejsazh të ri krijon argjinatura,

Me kangë të re sot due të hyj n'çdo prak,  
Pér kohn' e re due të kuvendi sonte...  
Le t'flasë pér mue n'lahutë rapsodi plak  
Pér kohën kur fusha me dnesë rënkonte.

\* \* \*

Tetdhjetvjeçarit Fran në dorë lahuta  
I dridhet, kur ai nis të ligjërojë  
Për robët mbetë pa bukë, për gjamë e futa,  
Për trimat dalë kaçakë, parzmet debojë.

Ndër pyje — prita cubash, e hakmarrja  
Çonte djelmoçat në t'vemuemet vorre.  
Vdekjen kudo mbillte mbi fushë malarja,  
Binin për mort kambanat ndër faltore,

Dritaret ngjyra-ngjyra. Harmoniumi  
Jone përhap ndër arat e mjerueme:  
«Ave Maria, gratia...» Dhe e ze gjumi  
Foshnjën e uritun. «Shkoi në jetë t'amshueme...».

Në vig la n'gjak sollën atë natë Martinin,  
Cokajt e vranë djaloshin syapatrembë;  
Dy mortje n'shi, — s'e qau lokja trimin,  
Prifti ngushllon: «Shpëtoi nga bota e rrëmë...»

Gjaksori ulej n'gjuj përpëra lterit,  
Me lutje duerët lan, gjakosë prej krimit,  
Për atë mëkat — një qese n'ndihmë të klerit,  
Pa faj prej kishës del ai mbas rrëfimit.

Po deri kur, ti moj kambanë mortore,  
Do t'i vajtosh sokolat t'premë në besë?  
Me grusht kërcnues gjëmon kjo nanë malsore:  
— Ku asht drejtësija, ku, o njeri i fesë? —

Nga Vatikani, Propaganda Fide,  
Qelat i mbushën plot me misionarë.  
Ti, n'emën t'Krishtit, «reverendo», shite  
Trollin e lashtë e popullin shqiptar.

\* \* \*

Populli rron. Atë shtypja s'e përkul.  
Ja, shqipet zbritën malesh, yjtë në ballë.  
Vështro! Flamuri i kuq mbi kullë asht ngulë,  
Mbi kullë, që tmerin fushës i pat kallë.

Qesh, bregamatas, tok me partizanë!  
Orteku i zhbiu anmiqt, që para gjet.  
Malsori sot asht zot i fushës nanë,  
Shërbëtor't e tokës erdhën në pushtet.

O vite t'para të lirisë së flakët,  
Tregonani si mnija popullore  
Porsi vullkan u derdh përmby kulakët,  
*Fusha* në kambë u *çue* në luftë *klasore*.

Xha Myrtja trim, Vuksani si duhia  
Me pushkë në faqe fushës vigjelojnë,  
Po djegin gjerdhet, farën, që robnia  
La pas, me zjarr ata po e shkrumbojnë.

Po kjo vocrrake me atë fustan t'arnuem  
E çantën krahëqafë ku asht kah shkon?  
E para vajzë asht nisë në shkollë me msuem,  
S'e tremb dëborë as shi, rrëpinë as hon.

Dhe Liza asht kjo, e para traktoriste,  
Që krah pér krah me traktoristat diva  
Çan tokat djerr, aty ku pushka kristë  
E tash sëpari u ngrit kooperativa.

Vitet kalojnë dhe toka merr shëndet,  
Ujnat jetdhanës nuk e mejnë vërshimin.  
Ja Liza jonë, sot n'universitet,  
Netët i gdhin tue konspektue Leninin.

Shkurti ka hy. Shoku Enver n'Tiranë  
Me komunistë mban t'zjarrtën ligjëratë.  
Në Breg të Matës hapet anembanë  
Kushtimi: mendjet me çlirue dhe gratë.

Fjala e Partisë n'çdo zemër thellë ze vend:  
Me djegë këdo, që shoqet merr npér kam'bë.  
Besën ka dhanë mbarë populli n'Kuvend,  
Kanunit t'mbrapshtë i erdhi dita e mbramë.

Flakën türkuzat e fejesat n'djep,  
Poshtë parazitët, shembën kumbonaret,  
Rinia hov ka marrë si shqipet n'krep,  
Për n'hekurudhë po nisen vullnetarët.

\* \* \*

Nga kështjella e lashtë e Lezhës hedh vështrimin  
Mbi fushë të gjanë me 'i bukuri të rrallë,  
Revolucionit i dëgjoj gjëmimin  
Dhe zemra m'rreh me dashuni e mall.

E sot kah vrej me mijë malësorë  
Reshtue përbri kanalit t'madh vaditës,  
Më ngjajnë të gjithë të jetës s're dasmorë,  
Më ngjajnë të gjithë luftarë pa frikë të dritës.

P A T R I O T È T

Ish ato dit' kur Peza kishte ftuar  
Shqiptarët më të mirë në kuvënd  
Që t'i bashkonte, jo për të luftuar  
Me kukurec, po me gjithë mënd:  
Me pushkë që bën bam e bukë-thatë,  
E jo duke përtypur çokollatë...

E kur atje buçiste e bubullinte  
Dhe flaka merrte dheun, në Tiranë  
Paria kombëtare hingëllinte  
«Për Shqipëri!» në grazhdet veteranë,  
Ku hante e s'ngopej, shtruar këmbëkryq,  
Tagjin' që i kishin vënë disa miq!

Ish ato ditë që i pashë ata të tre  
Duke pirë raki për mëmëdhe...

Çdo mbrëmje shkonin n'atë pijetore.  
Ishin: një tregëtar fort i praruar,

Një funksionar me një bastun në dorë  
— Shënje se rroga ecte e pandryshuar —  
Edhe i treti në seri — një tjetër  
Që e hiqte veten patriot i vjetër...

Ata miq kishin qenë kurdoherë,  
Po tani von' i bashkoi fort bardhaku  
Që kthenin në një qoshe dimër-verë,  
Sepse i brente fort ai meraku:  
Si do t'i bëhet halli Shqipërisë  
Që ra në duart e fëmijërisë...

Të tretin e thërrisinin «patrioti».  
Jo vetëm se nga mosha ish i shkuar,  
Po se ish një nga ata që, kur baroti  
Për mëmëdhe buçiste në krahruar,  
Ai, me sa tregonte, dhe kur flinte  
Vetëm atdhenë e dashur endërrinte...

Prandaj i bënин nder edhe e çmonin  
Këtë ushtar të vjetër t'idealit,  
Pasi, në fund të fundit, po mendonin  
Se, çunave që kishin dalë malit,  
Vetëm ky patriot me ca të tjerë  
Mund t'ua hante kokën menjëherë.

Dhe patrioti nuk përtonte fare  
Së foluri për ngjarjet kombëtare...

U fliste për Naimin — po pa shtuar  
Se e urrente që s'ish turçeli...  
Fliste me zjarr për shqipen e bekuar  
Sado që fliste turqe në shtëpi...  
Edhe pasi shpëlodheshe një grimë  
N'ato kujtime, me një psherëtimë,  
U thoshte për Çerçizin ndonjë fjalë,  
Për Mashkullorën edhe për Njëzetën-  
Po për vete nuk thoshte asnje fjalë  
Si e ku kish luftuar për kuletën;  
As për një shenjë plage mbi lëkurë,  
Që kish në mes të ballit, s'fliste kurrë...  
Po pikërisht kjo plagë mu në ballë  
— Që kish formën e plagës kombëtare —  
Të tjerë ua bënte mëndjen dhallë...  
Prandaj ata të dy s'dyshonin fare  
Se ajo shënje atje ish dokument  
I një patriotizmi permanent...

Nuk ishte vetë ky. Edhe të tjerë  
I qenë bërë Shqipërisë kurban  
Dhe e hiqnin veten patriot me vlerë  
Vetëm me shenjën q'u kish lënë... një çiban!

**KUR NDËRTOHEJ FABRIKA E XHAMIT**

Shkëputen shkëndija saldatriçesh nga kapriatat,  
Si në festën e vitit të ri  
Fishekzaret.

Treni «ekspres» drejt Elbasanit po më shpie  
Mbi Kavajë. Dalëngadalë po bie nata.

Ku ta takoja operatorin këto çaste  
T'i thoshja:  
«Hipja gazit dhe vrap malësisë?!»  
A mund ta kuptosh?  
Kjo breshëri saldatriçesh  
Ka vënë në shenjë frëngjité.

Xhiro, pra, një kinokronikë tronditëse,  
Se pasardhësit do na pyesin patjetër nesër:  
«Përse në kohën tuaj  
Me problemin e gruas  
Keni mbushur libra e gazeta?»

... T'u shfaqim frëngjité...  
Nga mugëtira e kullave  
Do pikojnë mblesë dhe derte vajzash...  
Nipërit dhe mbesat mbi ditët tona do përkulen  
Me laps në dorë si ne mbi «Kapitalin».

Sa më parë duhet xhiruar..  
Se breshëri e saldatriçeve  
Aq vend të madh do t'i ketë hapur dritës gjer nesër,  
Sa në dritaret që do zëvendësojnë frëngjité  
Mes për mes  
Mund të hyj unë me gjithë këtë tren «ekspres».

MOZAIKE

Tirana

Është qyteti i së dashurës sime.

Unë me Mehmetin kam lindur në jug!

Në jug piqen vishnjet —

Fletë të gjelbëra-kokrra të kuqe,

Ah kokrrat e tyre...

(Shpesh më shfaqen në ëndërr si pika gjaku,

Pikojnë pikë-pikë

në oborr të fëminisë sime).

\* \* \*

Tirana është qyteti i autobuseve dhe i gjelbërimeve.

Në rrugën e së dashurës sime lëkundet dielli,

Stuhi e mimozave gjithë rrugët mbush.

E dashura ime shkon me autobus.

Mehmeti ka në zemër sytë e nënës së tij,

Dy sy të ngrirë,

tragjikë,

me shikimin në kohën tonë.

\* \* \*

Metos, kur qesh,  
I formohen dy rrudha nën sy.  
Po këto s'janë rrudha të thjeshta,  
Ato ngajnjë me dy vija uji të thara

rrëzë një burimi:

Unë shpesh i shikoj  
Dhe më kujtohet rrjedha e gjakut të nënës së tij  
Ndanë udhës,  
Buzë një kojledhi. .

E dashura ime shkon me autobus;  
Në shqetësimin e qerpikëve të saj  
Më ruan mua.

Shoqja e Metos Meton pret,  
Në dritaren e pritjes atë e ze gjumi.  
Uturojnë urbanet. Porta troket. . .  
Shoqja e Metos fshin sytë e përgjumur:  
«Ti je, Mehmet? .»  
Mehmetit ky zë  
I kujton zërin e nënës që nën një gur po fle.

\* \* \*

Nëna e Metos nusen s'e dëgjon,  
Ajo është larg njëzet e pesë vjet.  
. . . Ëndërronte dasmën e djalit, krushqit te porta. . .  
Del te porta dhe pyet:

«Kush është?!

...Kush është?... — «*Tur auf maehen!*»<sup>1)</sup>  
...dhe ca krisma të forta.

\* \* \*

E dashura ime shkon me autobus,  
Studjon në filial, në universitet,  
Në shqetësimin e qerpikëve të saj,

që lëvizin  
si krahë dallëndyshesh,

Më ruan mua.

Unë shkoj dhe e marr atë çdo mbrëmje  
me bicikletë.

Mbi shtyllat e telegrafeve bie pareshtur dëborë.  
Shkëlqejnë fijet e kristalta strehëve të oborreve...  
Bicikleta rrëshqet. Të rinjtë rrugicave  
Na gjuajnjë pa pushim me topa dëbore.

\* \* \*

Qëllojnë ditë me shi...

Te stacioni i autobuseve

djemtë dhe vajzat e uzinës..

Pastaj shiu pushon.

Tirana në muzg. Dritat përpëliten varg.

Ti del në rrugë dhe kridhesh në një dritë të nejlontë..

Ku do të shkojmë tani, Meto?

Në Teatrin e operas,

Në bar-lulishte «Shqiponja»

Të hapim një dritare mbi fémininë tonë.

Po, Meto,

Kjo është koha jonë!

---

1) Hapeni portën!

BALLADE PËR HAXHIRE MYZYRIN

Në shtrat të saj të virgjër  
Nga dritaret  
Aromë e portokajve hidhej lehtë,  
Edhe mbi kaçurrelat  
Si alabastër.  
Veriu fëshférinte qetë–qetë  
Përtej derickës.  
Elbasani priste  
Agimin e lirisë në çdo prak;  
Krenar qëndronte  
Me të emblat qipshte,  
Ndaj çizmes së armikut  
Dhelparak.

Ajo dremiste.  
Yjet atje sipër  
E shihnin vezullonjës në mesnatë,  
E puthnin mbi qepalla,  
Duke zbritur  
Si xixa nëpër gjethë,  
Pa shamatë.

Në gjumë ndoshta  
Vajza éndërronte  
Hapësirat e Atdheut gjith' në festë,  
Nën tisin e flamurit  
Tonë të shenjtë.  
Por diç kërciti,  
Dern' e saj të lashtë  
Një dor' e huaj e tronditi fort.  
— *Kaput, kaput!*  
Dëgjuan portokajtë,  
Aty ku flinin  
Gjethe plot.  
U trëmbën yjet  
Nga çdo gjeth i gjelbër,  
Në quell heshtën si margaritarë  
Dhe panë si mbi sytë e saj  
Të qeshur  
Qepallat u tronditën;  
Dalëngadalë,

Ajo akoma shihte  
Si fitorja  
E mbushte gjithësinë me gëzim.  
Shikonte ende  
Rrotull banderola  
Në ajër të valviste,  
Pa pushim,  
Era e natës  
Nga dritatret futej,  
Në terrin e mesnatës, gjer atje.  
Dhe deg' e portokallit

Sa s'këpütej,  
Duke e thirrur èmbël  
— Haxhire!  
Dera gjëmoi.  
Në oborr nazistët  
U derdhën të zemëruar një nga një,  
— *Kaput, kaput!*  
Si uragan bërtitën,  
Duke u sulur rëndë mbi atë.  
Një dorë xhelati  
Nga gërshteti e zuri.  
Trupi i saj i hajthëm u gremis.  
Ajo s'u tremb, s'u qa,  
Por gjoksin vuri,  
Përpara fundit,  
Sikur vdekje s'kish.

Atje mbi gurët  
Që i pati rrahu  
Me këmbët vajzërore mijëra herë,  
U dergj përkrah të vëllait,  
Të përgjakur,  
Agimin duke parë si pérherë.  
Gjethet e bruzta  
Ulën portokajtë  
Mbi sytë e venitur me trishtim;  
Si xixa yjet  
Nëpër gjethë ranë,  
Në gjak e panë veten  
Pasqyrim.

Me këtë gjak  
U lagën udhët tonë,  
Dielli i fitores u stërpik.  
Ajo nuk vdiq,  
Me ne jeton akoma,  
Në erën e pavdekshme  
Endërin,  
Në shtrat të saj prej yjesh,  
E qetuar,  
Agimin elbasanas  
Sheh gjithnjë.

**EPOPEJA E BALLIT KOMBËTAR**

(poemë — fragmente)

II

Vate dhe dimri,  
Se kaq e pat.  
Zogj e bullica <sup>1)</sup>  
Z'gnejnë më rehat,

Se gjethja çeli  
Dhe malet plot  
U mbushnë akoma  
Armë e barot.

— Një kupë verë  
Garson, në daç!  
Sot me të lutur,  
Dje me kërbaç. . . .

---

1) Zogistë e ballistë

Thuaj ç'të duash,  
Të njoh, më njeh,  
M'i di të gjitha,  
S'kam ç'të të fsheh

I tillë isha.  
Po jam penduar,  
Sot me të gjitha  
Jam dorëzuar.

Kështu e paska  
Kjo botë jallane:  
Ngryse piperkë,  
Gdhin patëllxhane.

Kush e kish njohur  
Lanetin Ball?  
Vate na futi  
Në këtë hall!

Krerët për vete  
Bëjnë si bëjnë,  
Po ne bishtprerët  
C'udhë të gjejmë?

Udhën e malit?..  
E di, o vëlla,  
Po jam dénuar  
Dhe nuk ma mba.

Në ke mëshirë,  
Gjemë shpëtim:  
Nëmë <sup>1)</sup> një letër  
Rekomandim.

Ke kushëririn  
Në batalion  
Dhe fjal' e tija  
Ku nukë shkon! —

U ranë pendët,  
Se dhe gjermani  
Po përdredh bishtin  
Si italiani

.....

Shtëpitë e krimit  
Nxijnë e sterrojnë,  
Ëndrrat, fallxheshat  
Shumë keq tregojnë:

— Të të rrëfenj,  
Të të dëftenj,  
Keq, zonjë, e paske  
Me fukarenj. . .

---

1) Më jep.

Liksht dëftuakan  
Bathët<sup>1)</sup>, pér besë,  
Hatéri, qejfi,  
Zonjë, mos jesë:

Sikur nga malet  
Një lumë zbret  
Dhe merr me vete  
Bej e dovlet... —

Zonjush Leilasë  
S'i ndrit më nuri,  
Ka varur buzët  
Si streh' hauri.

Dhe Hanko zonjës,  
Aq sa kish hije,  
I nxin sot balli  
Si fund kusije.

Pa flet e çirret,  
Thërret, bërtet,  
Është mbushur tërë  
Nervozitet:

---

1) Arixhofkat, kur hedhin fall, kanë zakon të përdorin një grusht bathë; në këto bathë shohin gjoja të ardhmen e tjetrit.

— S'bë' gjë es-esi,  
As Fritz Kaputi, <sup>1)</sup>  
S'mbaroka kurrë  
Kjo farë harbuti, <sup>2)</sup>

Si farë e hithrës,  
Që mbush dynjanë,  
E pret këtu,  
Të mbin matanë.

C'bëni ju burrat?  
Ju humbtë vula!  
Haram i paçi  
Byrek e pula.

Se turpëruat  
Komb e Atdhe...  
Doni t'ju vijmë  
Prapa dhe ne?

Këtë e bëri  
Harbutëria.  
Si mund ta bëjë  
«Ristokracia?! —

---

1) gjermani  
2) partizanët

— Lërna, moj grua,  
Se s'jam hiç mirë,  
Kam plot një javë  
Me gjak të ngrirë.

Ç'hyjnë më llafet  
Në këtë mes?  
Ne kemi vajtur  
Në teknefes.

Lërna, të thashë,  
Për kokë tënde;  
Ata po vijnë...<sup>1)</sup>  
Ti na shet mende.

\* \* \*

Thonë, Gjermanët  
Prap' po sulmojnë,  
Shqiprinë e Jugut  
Do ta rrrethojnë

---

1) Është fjala për partizanët, që shumë herë zbritnin në formacione të vogla brenda në qytete dhe kryenin aksione me rëndësi. Kjo ndodhë dendur dhe pothuas në çdo qytet. Po më e bukura ajo që ndodhi në Vlorë: në kohën kur gjermanët operonin me forca të mëdha në krahinën e Mesaplikut dhe hapnin fjalë për «**Katas-trofën më të madhe që po pësonin partizanët**», një skuadër partizane futet natën në Vlorë dhe me automatikë e me bomba sulmon burgun dhe zyrat e komandës naziste. Krerët e Ballit të Vlorës u zgjuan të pataksur dhe, duke pandehur se erdhi fundi, ngarkuan plaçkë e familje në kamionë dhe për tërë natën zu Tiranën.

Dhe prak e vatër  
S'do lënë më këmbë,  
Njerëz të gjallë  
Do hanë me dhëmbë.

Me ta dhe Balli,  
Si bisht sqepari,  
Pushtet kuislingun  
Do ngrerë i pari.

**SI NË BRONX, DERDHUN MONUMENT**

Ashtu si vjen nji erë pranverore  
E fushat i ngjall e kodrat gjelbëron  
E u ngjitet bjeshkëve si ugur jetdhanës  
Tue ndritë fytyrat e bare shave,  
Tue gzue zemrën e bujkut,  
Ashtu erdhe ti,  
A fjala e 6 shkurtit!

I egër, i zymtë, i akullt  
Asht dimni,  
Që u vishet fushës e shpatit,  
Por tri herë mizor kanuni  
Dhe ligjet e kishës e shariatit.

Përballet e zhdukët dimni,  
Përkulet acaria ma së voni,  
Por jo kështu zakoni.

Nji rrufe e çan nji lis  
E hedh për tokë,  
Por as nji qind s'e djegin  
Mykun e ngjeshun në kokë.

Ishe ma e fortë se njiqind rrufe,  
Në kulm të stuhisë  
Ti, fjala e 6 shkurtit,  
Trumbetë e partisë!

Me mijë e qindra mijë gra e vajza  
Betohen n'emnin tand,  
Hedhin tutje shamitë  
Dhe frikën,  
Shpërvjelin mangët  
Në uzina, shkolla, ara  
E çajnë përpara.

Rranjët tueja janë të thella:  
Në vitin e kuq dyzet e nji  
Degët tueja janë të nalta:  
N'hapsinën e socializmit.

Dhe nesër, kur të jenë rritë  
Ato që sot përkunden,  
Do të kujtojnë nji vit, nji ditë,  
Nji sulm revolucionar,  
6 shkurtin flamurtar.

Në alpet kunorë-bore,  
Në fushat e pafund të Myzeqesë  
E deri në piramidet jugore  
Ti rend, rend  
Si flakë olimpike  
Dhe kudo ndrin  
Si në bronx, derdhun monument.

**FSHATI KARBANJOZ**

Tetë shtëpi dhe kroje të bardhë,  
Tetë praqe dhe tetë frëngji...  
Lidhën kokrrat e reja të thanës,  
Ostrovica veshi gjethin e ri.

E shikon atë Uashingtoni,  
Tok me Romën edhe Boni plak,  
Qiell gërvishëse <sup>1)</sup> të hekurta, shikoni  
Këtë fshat që zbardhon përmbi mal!

Skuqin thanat mbi murin e bardhë.  
I vadit kroi i njomur me gjak.  
Erdhën ushtarët tuaj barbarë  
Që ta shkelin me thembër çdo prak.

Ranë thanat dhe gjethet e brishta,  
Në çdo krua u vra një trim.

---

1) Grataçielë.

Po të hapura mbetën frëngjité,  
Skuq hakmarja në to si kujtim.

Tetë shtëpi dhe kroje të bardhë,  
Tetë praqe dhe tetë frëngji,  
Dekoratë trimrie të zjarrtë  
Ostrovica i mban përmbi gji.

P E R P A R A

(Fragment)

Rrëshqet maqina mbi asfalt të ndritun  
nga rrezet pranverake.  
Parakalon bleroshe, e përtëritun,  
natyra fusharake,  
kallijtë e grunit, që më furfurijnë,  
tek lehtë i puth puhiza ledhatare.  
Atje, ku qe djerrinë,  
rrëgallë apo ledhishte  
e, tej, në pllaja t'hapëta mitare,  
buthtohen hijshëm vneshta e pemishte;  
shtëpitë e reja zbardhëllojnë larg  
me qipshte rrëth e qark.  
Kalojnë ndër ara, etjen tue fashitë,  
e vijat e hullitë.  
Çdo pllambë e tokës arbnore matet  
me gjak e lot e djersë shekullore,  
por vetëm sot po i sharton, popull, fatet  
si zot i s'ardhmes s'lumtun njerëzore.  
Të ligat, që të hapën brengë e plagë,  
po zhduken tok me barnat e këqia,

Këtë trupin tand, që anmiqtë ta patën ndragë.  
seç ta pastroi Partia.

N'damart' e tu, Atdhe, rrjedh gjak i dlrë,  
për punëtorët rreh kjo zemra jote.

O populli im i lirë,  
sa i vogël je, po i madh ti ndrit në botë!

Të përshëndes, o tokë amtare,  
e lirë, e shtrenjtë, gratçore.

Ju falem, duer të arta punëtore  
e duer t'forta katundare,  
t'bashkueme përgjithmonë  
për lulëzimin e Atdheut tonë.

natyra fusharake,  
kallintjtë e grunit, që më farfurijnë,  
tek lehtë i puth puhiza ledhatare.

Atje, ku qe djerrinë,  
rrëgallë apo ledhishte  
e, tej, në pllaja t'hapëta mitare,  
buthtohen hijshëm vreshta e pemishte;  
shtëpitë e reja zbardhëllojnë larg  
me qipshte rreth e qark.

Kalojnë ndër ara, etjen tue fashitë,  
e vijat e hullitë.

Çdo pllambë e tokës arbëore matet  
me gjak e lot e djersë shekullore,  
por vetëm sot po i sharton, popull, fatet  
si zot i s'ardhmes s'lumtun njerëzore.

Të ligat, që të hapën brengë e plagë,  
po zhduken tok me barnat e këqia.

Këtë trupin tand, që anmiqtë ta patën ndragë,  
seç ta pastroi Partia.

N'damart' e tu, Atdhe, rrjedh gjak i dlrë,

për punëtorët rreh kjo zemra jote.  
O populli im i lirë,  
sa i vogël je, po i madh ti ndrit në botë!  
Të përshëndes, o tokë amtare,  
e lirë, e shtrenjtë, gratçore.  
Ju falem, duer të arta punëtore  
e duer t'forta katundare,  
t'bashkueme përgjithmonë  
për lulëzimin e Atdheut tonë.

\* \* \*

Rrëshqet maqina fushës së begatë.  
Ushtari përshëndet me gaz t'rini.  
Kjo rruga jonë, e ngushtë edhe e gjatë,  
sa e gjanë e e shkurtë u ba drejt lumtunisë!  
Të bukurën e gjeta n'ty, Atdhe;  
me ty të mirë e t'keqe i kalova;  
thesar i ndritshëm përmbi dhe,  
vetëm n'gji tandin lumtuninë kërkova.  
Kënaqësi krenare ndej në shpirt,  
se biri yt un jam.  
Ti, pra, ma jep frymëzimin aq të dli.  
Krijimin ma të bukur borxh ta kam.

\* \* \*

Si t'mos besoj në pritmin ma të mirë,  
kur shoh tek nji gëmushë  
e afër nji korie,  
nën qiell arbnor të lirë,  
delmerët vogëlushë

me krrabë e libër n'dorë-etsue për dije?  
Ata me libër e me krrabë në dorë,  
me pushkë e kazmë na, ndërtues e roje,  
gjith'afsh krijimi, populli punëtor  
një kopsht me lule po i ban këto troje.  
Si gonxhet, që na çelin në pranverë,  
ashtu talentet çelin mbarë — e — mbarë.  
Po, po, nga ata delmerë,  
sa minatorë, veterinerë,  
sa agronomë e inxhiniere,  
sa mjekë e sa poetë,  
pilotë e komandarë  
kanë për t'u ba në jetë!  
E ardhmja asht e tyne. Unë e di.  
Atdheu ua zbulon  
me frymë të vet tu'i pri,  
dhe ashtu, si mue, i fton.

\* \* \*

Kalojmë na në rrugën e vadirun  
nga loti, gjaku e djersa e veprimit  
dhe e krijimit.  
Kurrgja s'e ndal Atdheun e përtëritun  
që të gézojë përor  
pranverën e pavdekshme të njërzimit.  
E ti, o populli fatos punëtor,  
nga thellësi e shpirtit brohorit  
me besë  
e shpresë  
për t'ardhmen, që shëndrit:  
Përpara! Ekselsior!

**ÇIKAT E MALEVE DHE DRINI**

(poemë)

**I**

Përdridhte, shpesh, mustaqet si pollogë  
Lekë Dukagjini,  
Nga lum' i Matit gjer në Bogë  
E gjith vadës së Drinit.

Dhe kur përplaste prej zemrimit këmbët,  
Despot' i egër i Malësisë,  
Gërmadha tymi ngriheshin mbi tokë.  
E i mbetej fjala gruas nëpër dhëmbë  
Si një kothere e thatë  
Shumë e fortë.

Se fjal' e tij ish ligj... dhe ligj i rreptë,  
Që duhej ta përtypje dhe kur s'përtypjej kurrë:  
Të hidhej vajza prej greminës s'egër  
(E c'mund të bënte tjetër çikë e ngratë?)

Apo të shitej posi dhi në treg  
Te kushdo burrë,  
Që numëronte si xhambaz paratë?

Por, ja: ashtu siç rriten majave borigat  
Të gjelbërta, të drejta, të shëndetshme  
E s'tundeshin nga rrebeshet e dëbora, —  
Ndër këto gërxhe t'ashpra rriteshin çika:  
Shota Galica,  
Mrika, Shkurta, Nora...  
Krenare si borigat mbi majat e përjetshme.  
Dhe kur, papritur, mu si erozionet  
Armiqtë rrëth sulmonin këtë vend,  
Nuk i lëshonin çikat pozicionet  
Dhe kur krasiteshin nga plumbat e nga shpatat  
Krent<sup>1)</sup>!

Luftonin gratë, shpesh, me burrat bashkë  
Qëllonin tok me ta të njëjtën shënjë...  
Me gishtat delikat' u lidhnin plagët,  
Rrëmihnin varre për të rënët.

Dhe m'ato duar të stërvitura,  
Në magje, në qilizmë  
Apo në tharje,  
(Edhe kur ndodhnin çika të parritura)

---

1) Degët e lëngëzuara të ahut që e hanë shumë dhitë.

Shkonin me heroizëm  
Në hakmarrje.

Po, rrallë e tek ka njojur bota  
Krenare si Teuta  
Dhe si Shota!

Por, kur mbaronte nëpër majë lufta  
E u thureshin qindra këngë trimërive,  
Me çifteli, me fyej e lahuta,  
(Q'u lidheshin trashëgim mu si thesar breznive)

Ndërsa vazhdonin këngët ehon grykave gjer vonë,  
Trimreshat kyçeshin mes mureve  
Pas një brave...  
Dhe pasi varnin pushkët në peronë,  
Jetonin në shtëpinë e vet sërishmi...  
Skllave!  
Dhe vrenin nga frëngjitet me pikllim,  
Duke u djegur flakë e prush përbrenda  
Tek, lahej hën' e plotë,  
Hën' e lirë... nëpër Drin.

E mijëra dëshira, dashuri  
Dhe èndërra,  
Që dergjeshin, tok me to, në një qeli:  
Gjith' mall për hapësirat e maleve të lartër.  
I flaknin plot shqetsim  
E dhëmshuri,  
Në shtratin tënd, o Drin...  
Qivur i kaltër.

Edhe kështu,  
Me vite e shekuj rresht,  
Si një hamall varrimesh,  
O Drini Plak:  
Varrosje shpresat, brengat, ëndërrimet  
Diku larg...  
Në det.

. . . . .

## II

Kam dalë sonte dhe shëtit në lumë  
Në këtë natë vere kaq të vakët.  
Shëtit... në zall' e ngrohtë zbathur  
Posi dikur në fëmininë e largët  
Dhe nuk kam gjumë...

Shëtit e vërvshëllej një melodi të re.  
Djalosh ëndërrimtar,  
Pa thinjë, pa halle,  
Dëgjoj si zgjohen gjethet në dremitje...  
Dhe s'më shpëton as dhe një shushuritje.

Por shpejt ndaloj në vend: ç'të jenë ato atje:  
Sirena, zana, apo shtojzavalle?  
E kujt i kanë zënë, vallë sonte pritë?  
Po pse nuk paskan hedhur supeve ndonjë re  
Të purpurtë  
Si shall të trëndafiltë?

Ato nuk janë ora e shtojzavalle,  
Po çika vullnetare.  
I kanë lënë futat e xhubletat,  
I kanë lënë syskat edhe bejlekat;  
Nuk vënë dushk, për dimër, majë bigës  
Dhe nuk ngarkojnë dru nëpër tërkuza:  
Po ngrenë çikat mur' e madh të digës,  
U këndon zemra dhe u qeshet buza!

Nuk janë më ato të bindura si delet,  
Që mund t'i mbajë kyç çfardo lese,  
Lëshuar nëpër ballë kaçurrelet,  
Stolisur faqet me sumbullo djerse:  
Po mbajnë gurë çikat në tezgere...  
Mbi Drin vrapojnë yjet,  
Natë vere.

Dhe shumë vonë, kur punën e lënë,  
Na marrin të gëzuara një valle.  
I lan nëpër flori e bukura hënë  
Të hijshmet shtojzavalle... vullnetare.

Veç nga kjo këngë e flaktë buzë Drinit,  
Na zgjohet tërë inat Lekë Dukagjini:  
(Kushedi nga c'djall magjie dhe nga c'lëng  
Ky burr' i egër qenka bërë shkëmb?)  
I thinjur, hijerëndë, Perëndi,  
Vështron ai vullnetarët plot mëri  
Dhe murmurit, ashtu, me zë të çjerrë.

— Ku jeni rritur ju ku kemi lerë?  
Jeni peri a çika? A ç'dreq xhins?! —  
Hedh syt' e zgurdulluar rreth e qark  
E duket midis shkrepave një sfinks:  
I tmerrshäm, i perëndishäm...  
Por qesharak.

E tallen çikat, qeshin...  
Dhe vallen asnë çast s'e lënë.  
U merr ky fllad i malit kaçurrelet,  
E qeshin çikat, qeshin plot potere;  
I lan nëpër flori e bukura hënë.  
Mbi Drin vrapijnë yjet...  
Natë vere.

**MES VARGJESH**

Unë akoma s'të kam thënë asgjë  
(Ndërsa kaq shumë dua të të them!).  
Merri sot vargjet e mia  
Dhe dashurinë time për ty  
Atje e kam futur,  
atje ti e gjen.

**HARKUN LART**

*Violinistit I. Madhi*

Fërferinë fletët e mollëve dhe thanë  
Fjalët e violinës tënde,  
Cicërinë fëmijët e kopshteve dhe thanë  
Fjalët e violinës tënde, Ibrahim;  
Vërshelleu basi i lokomotivës, përhapi  
Fjalët e violinës tënde,  
Fjalët e violinës tënde përhapën dhe ujvarat,  
Ujvarat e bjeshkëve.

Unë i dëgjova dhe erdha  
Në koncertin tënd.

Kokën e mbështete prapë mbi violinë  
Si mbi kraharorin e shqetësuar të së dashurës.  
Lulëzuan nëpër brazdat e trurit  
Pentagramet e gjelbëra.

Ku do na shpien sonte, Ibrahim?  
Salla éshtë plot pritje dhe heshtje,  
Zemrat tonë të çelura  
Për këngët.

Ku do të na shpiesh sonte?

Fushat kanë grurë,  
Malet kanë bakër,  
Qiejt — avionë.  
Ne kemi fushat, malet dhe qiejt e kaltër,  
Ne kemi këngët.  
Violina jote éshtë shumë e gjëzuar. Harku lart.  
Harku poshtë, sikur kërkon.  
Nëpër mineralet e çmuara të thesarit të popullit,  
Nga dolle.

Qemali vetë  
Do të kish zbritur nga piedestali, do të vinte  
Në koncertin tënd, do të të puthte  
Në ballin tënd të rrudhur si fushë pentagrami.

Violina e tij mbeti e varur në mur, e varur  
Në zemrat tonë mbeti violina e heroit.  
Violina jote, —  
Vazhdimi i një këngë, të cilën nuk mund të mos  
e këndojmë

Fushat kanë grurë,  
Malet kanë bakër,  
Qiejt — avionë.  
Në kemi fushat, malet, qiejt e kaltër,  
Në kemi këngët.

Harkun lart,  
Harkun lart, Ibrahim.

**NË KONVIKT**

Hyri me Lilin dashuria,  
Si para gjyqit, në konvikt.  
Tre nga ne e mbrojtën si jetën,  
Dy i druheshin si një babe fanatik.

\* \* \*

Pse u var kështu heshtja  
Bashkë me pardesynë blu të Lilit prapa derës?  
Të shqetësuara lexojnë ndër rrjeshta  
Shoqet që shikimin ulin njëherësh.

Sa gjëra të bukura do të flasë Lili!  
Në shikim i lundron dashuria,  
Por... ç'kanë kështu shoqet, ç'kanë?!  
Pse vështron e heshtur Bukuria?!

«Hë, flisni,  
godet heshtjen Ana

Ju që gjer tani folët aq shumë!»  
Lili mbledh supet e njomë  
Dhe mendimet e mbytin si lumë.

«Unë nuk thashë asgjë,  
vërtet nuk thashë...»  
Bluan nëpër dhëmbë një vajzë.  
Lili hedh shikimin nëpër shoqe  
Sikur do të hidhet nëpër dallgë.

Hyri me Lilin dashuria,  
Si para gjyqit, në konvikt  
Tre nga ne e mbrojtën si jetën.  
Dy i druheshin si babe fanatic.

E solli Lili dashurinë  
Këtu në dhomë, në konvikt,  
Si një pranverë të bukur,  
                                  të ngrohtë  
Që akuj fanaticizmi zë e shkrin.

BALADË SHQIPTARE PËR LENININ

Ai hyri në pallatin ku ish parlamenti.

Në brez: revolveri ende i nxehtë nga vrasja e Esat Pashës  
në Paris;

Hyri dhe tha shkurt e saktë si pesë të shtëna revolveri:  
Zotërinj,

Pesë minuta heshtje,

Lenini vdiq!

Të gjithë më këmbë,  
Më këmbë të gjithë!

Shtangën drurët. Zogjve kënga në buzë u mbeti,  
Me një kuje të tmerrshme qau e klithi era,  
Globit për një çast i humbi graviteti,  
Dielli humbi shokun, shkau e ra në humnra.

U ranë varetë nga duart kovaçëve,  
Parmendën në mes të brazdës fshatarët ç'e lanë  
O ç'heshtje e rëndë!

Një heshtje e tillë  
S'ish ndjerë ndonjëherë,  
S'ish parë në asnë dramë.

Pesë minuta heshtje,  
Lenini vdiq! ..  
Të gjithë më këmbë,  
Më këmbë të gjithë!  
Pallati u lëkund  
Këmbëtrokitje në sallë.  
«Baballarët e kombit» njëri-tjetrin panë në sy:  
Ai nga Rusia,  
Ky nga Libohova,  
Ç'djall i nxori në një breg të dy?!

C'u kujtove vdekjen, Avni, «Baballarëve»!  
Ata për zgjerimin e gjerdheve të tyre ëndërronin  
— Vdekjes suaj t'i ngriheni  
Të gjithë më këmbë —  
Fjalët e tua gjëmonin.

Kjo s'kish ngjarë asnëherë,  
Asgjëkundi s'kish ngjarë,  
Zotërinjtë më këmbë Leninit?!  
Zotërinjtë s'janë komunarë.

Tokën deshën të na ndanin nga ngastra,  
Po mbi traktatet u lëshua Lenini i tmerrshëm  
Leninin ish i madh sa kreshnikët e elegjive tonë të lashta,  
Ai s'kish lindur në Simbirsk, po në të pesë kontinentet  
njëherësh.

Vallë si e gjeti udhën mes këtyre shkëmbinjve  
Lenini — zemër e gjithkujt?  
Tokën Lenini ua dha fukarenjve,  
Tokën e tundi...

Lenini, si askush, u qau hallet të mjerëve,  
Hallet që s'ua qanë dot as malet me dëborë,  
Lenini se ç'kish diçka të përafërt me malet,  
Lenini vuante nga tragjedia jonë.

Pa ç'ka që të mjerët as emrin Leninit nuk dinin t'ja shkrua-  
nin;  
Leninin e kuptionin: Ai, si ata, s'kishte bukë.  
Lenini kish thënë:  
Sarajet do të shemben,  
Po të ngrihen kasollet në luftë.

Pesë minuta heshtje,  
Lenini vdiq!  
Të gjithë më këmbë,  
Më këmbë të gjithë!

Shtangën drurët. Zogjve në buzë kënga u mbeti,  
Me një kuje të tmerrshme qau e klithi era  
Globit për një çast i humbi graviteti,  
Dielli humbi shokun, shkau e ra në humnerë.

Diçka drodhi malet, që as qepallat s'kishin luajtur në  
shekuj,

Malet gjokszbuluar që prisnin stuhinë.  
Populli «Ngreu!» i tha parlamentit,  
Populli ngriti mbi parlamentin djalin e tij, Avninë.

Të të gjithë do të zgjohej brez pas brezi Lenini,  
Po dhimbja ish e madhe;  
Populli betohej se do ta ruante  
Si malet.

Dihet kë ruajnë malet.

Pesë fjalët e Avni Rustemit, pesë të shtëna:  
Vdiq Lenini,  
Pesë minuta heshtje!  
Mikrofeudoborgjezët u ngritën për Leninin më këmbë.  
Po vdiste parlamenti.

---



## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
ADELINA MAMAQI — Fshati zbardh .....	3
AGIM GJAKOVA — Drini i bardhë për shokun Enver .....	4
AGIM SHEHU — Para bustit të Selam Musait .....	6
ALEKS ÇACI — Ashtu Myzeqe (poemë — fragmente) .....	12
ANDREA VARFI — Kush ndjen mahnitjen e agimit .....	18
DIONIS BUBANI — Orët e vdekura .....	21
DRAGO SILIQI — Kur pyesja nanën .....	22
DRITËRO AGOLLI — Baballarët (poemë) .....	25
DHIMITËR SHUTERIQI — Mëngjez votimesh .....	40
DHORI QIRIAZI — De Rada .....	44
FADIL KRAJA — Ju flet Tirana .....	46
FASLLI HALITI — Pas mbledhjes .....	48
FATMIR GJATA — Ato maja rriipa-rriipa .....	49
FATOS ARAPI — Isha kaq i vogël... (poemë) .....	50
FERHAT ÇAKËRRI — Ballada e djalit .....	56
FREDRIK RESHPJA — Ullinjtë .....	57
GJOKË BECI — Kur zgjohen bjeshkët .....	61
HIQMET MEÇAJ — Pranë ullinjve .....	62
IBRAHIM GANI — Rrëkeja rrjedh nën kapotë .....	65
ISMAIL KADARE — Vitet gjashtëdhjetë (poemë) .....	67
KIÇO BLUSHI — 22 prill .....	82
KLARA KODRA — Kur shoh botën në sytë e fëmijës .....	86
KOLË JAKOVA — Heronjt e Vigut (poemë — fragmente) ..	87
KOSTANDIN DHAMO — Shote Galica .....	90

	Faqe
LIRIM DEDA — Për ata që vijnë nga fshati .....	92
LUAN QAFËZEZI — Poemë për Sekretarin .....	95
LLAMBRO RUÇI — O Talo, motër! .....	101
LLAZAR SILIQI — Një kangë e re sot nisi fluturimin .....	102
MARK GURAKUQI — Gjurmët .....	108
MOIKOM ZEQO — Pranë njerëzve .....	111
MUSA VYSHKA — Këngët e vendlindjes .....	113
MYZAFER XHAXHIU — Dritë .....	115
NATASHA LAKO — Nuk më le bora të shoh .....	116
NDOC PAPLEKA — Ëndrra e Destanit .....	117
NIKO KACALIDHA — Dritë .....	119
NONDA BULKA — Mujo Ulqinaku .....	120
PANO ÇUKA — I rilinduri .....	123
PETRO MARKO — Vajza e Labërisë .....	124
SADIK BEJKO — Udhët do të zgjaten .....	126
SANDËR GERA — Kudo vlon kanga .....	130
SANDËR BANUSHI — Rapsodi bregamatase .....	132
SPIRO ÇOMORA — Patriotët .....	137
SPIRO DEDE — Kur ndërtohej fabrika e xhamit .....	140
SULEJMAN MATO — Mozaikë .....	142
SHEFKI KARADAKU — Balladë për Haxhire Myzyrin ..	145
SHEVQET MUSARAJ — Epopeja e Ballit Kombëtar (poemë — fragmente) .....	149
TONIN MILOTI — Si në bronx, derdhur monument .....	156
VANGJUSH ZIKO — Fskati Karbanjoz .....	158
VEHBI BALA — Përpara (fragment) .....	160
VEHBI SKËNDERI — Çikat e maleve dhe Drini (poemë) ..	164
VLLASOVA MUSTA — Mes vargjesh .....	170
VIKTOR QURKU — Harkun lartë! .....	171
ZHULIANA JORGANXHI — Në konvikt .....	174
XHEVAHIR SPAHIU — Balladë shqiptare për Leninin. ....	176

Tirazhi 1500 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-65

---

Shtyp. NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»

Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1970